REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

# RELACION
# PROGRAM BUXHETOR
# 01 Janar – 31 Dhjetor 2023

**Tiranë, Dhjetor 2022**

# PËRMBAJTJA


I. HYRJE

II. MISIONI

III. PERSPEKTIVA 2023

IV. BAZA LIGJORE MBËSHTETËSE E KËTIJ PROJEKT BUXHETI

V. TREGUESIT KRYESORË TË BUXHETIT PËR VITIN 2023

V-1 TË ARDHURAT E PRITSHME PËR PERIUDHËN 01JANAR – 31 DHJETOR 2023

V-2 SHPENZIMET E PARASHIKUARA PËR PERIUDHËNJANAR –DHJETOR 2023

V-3INVESTIMET E PARASHIKUARA PËR PERIUDHËJANAR –DHJETOR 2023

VI. PËRMBLEDHËSE E KËRKESAVE BUXHETORE 2023

# I. HYRJE

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucion publik jo-buxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka selinë e vet në Tiranë.

Sistemi i pronësisë industriale është mjeti juridik që siguron mbrojtjen dhe rregullon të drejtat e pronësisë mbi patentat për shpikje, markat tregtare, disenjot industriale, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Pronësia industriale është e lidhur ngushtë me inovacionin dhe luan rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe shkencor. Ekonomia inovative bazohet në idenë se dija, inovacioni, teknologjia dhe sipërmarrja janë forcat e zhvillimit ekonomik. Në një ekonomi të bazuar në dije, kapaciteti dhe kreativiteti inovativë janë një temë e rëndësishme për rritjen ekonomike.

Sa më të forta të jenë politikat e mbrojtjes së sistemit të pronësisë industriale të një vendi, aq më e zhvilluar do të jetë ekonomia e tij, prandaj ajo duhet njohur, vlerësuar dhe mbrojtur maksimalisht nga politikat shtetërore, sipërmarrësit, individët dhe e gjithë shoqëria në tërësi. Ky sistem fuqizon bizneset, industritë dhe individët për të mbrojtur krijimet e tyre inovative intelektuale dhe rezultatet e veprimtarive të tyre kulturore dhe krijuese.

Fusha e zbatimit të pronësisë industriale duhet kuptuar gjithashtu në një kuptim më të gjerë dhe duhet të zbatohet dhe aplikohet jo vetëm në industri dhe tregti, por gjithashtu në bujqësi dhe industritë nxjerrëse dhe për të gjitha produktet e prodhuara ose natyrale.

Kjo u jep atyre mundësinë të gëzojnë të drejtat e tyre morale dhe të komercializojnë të drejtat e tyre materiale që burojnë nga puna dhe investimet e tyre inovative dhe krijuese.

Mundësia për të nxjerrë vlera të përshtatshme ekonomike nga puna dhe investimet e tyre inovative dhe krijuese është shumë stimuluese për punën dhe investimet e mëtejshme.

Të drejtat e pronësisë intelektuale janë mjeti për mbrojtjen ligjore të atyre forcave lëvizëse. Kjo është arsyeja themelore pse vendet duhet të zhvillojnë një sistem të besueshëm dhe të mirëfunksionuar të pronësisë intelektuale.

DPPI gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit midis institucioneve, palëve të interesit dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në sistemin kombëtar

të pronës intelektuale, si dhe midis universiteteve dhe institucioneve arsimore dhe sipërmarrësve, në të gjithë vendin

## II. MISIONI

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka si mision të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes, regjistrimit, dhe promovimit të këtyre të drejtave, për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian;

- ***Fokusi*** *i DPPI-së konsiston në stimulimine rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet forcimit të ndikimit të sistemit të PI në zhvillimin ekonomik të vendit. Në mënyrë specifike, do të shërbejë si një mjet për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe për të garantuar suksesin në treg.*

- ***Mbrojtja*** *e sistemit të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë bazohet në legjislacionin kombëtar si edhe traktatet e konventat ndërkombëtare në të cilat, Republika e Shqipërisë është anëtare;*

- *DPPI* ***synon*** *rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e sistemit të regjistrimit, administrimit dhe mbrojtjen e së drejtave të objekteve të pronësisë industriale. Gjithashtu, të sigurojmë përafrimin ligjor me standardet e BE-së dhe me praktikat më të mira përmes transpozimit të duhur të ligjeve të BE dhe për të përmirësuar ligjet si të dobishme dhe të përshtatshme në fusha specifike në përputhje me praktikat më të mira evropiane.*

## III. PERSPEKTIVA PËR VITIN 2023

Qëllimet strategjike të DPPI bazohet në objektivat e ndërmara nëStrategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025 dhe konkretisht synohet të arrihet:

Qëllimi i kësaj Strategjie është të stimulojë zhvillimin ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, të sigurojë një funksionim të duhur të tregut të brendshëm duke vendosur ekuilibrin e duhur midis interesave të pronarëve të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe interesave të përdoruesve, dhe forcimi i sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së pronës intelektuale. Ky qëllim strategjik duhet të arrihet duke siguruar mbrojtje të besueshme dhe efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe duke inkurajuar, zhvilluar dhe shfrytëzuar ekonomikisht pronën intelektuale. Të pesë objektivat tregohen

veçanërisht në Strategji: përmirësimi i kornizës ligjore, zhvillimi dhe forcimi i kornizës institucionale, forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, si në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, ngritja e vetëdijes për rëndësinë e sistemit të pronësisë intelektuale, si dhe identifikimi i treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës.

Fokusi i DPPI-së në planin e aktiviteteve promovuese për vitet 2022–2023, do të jenë:
- Institucionet e arsimit të lartë vendëse për nxitjen e punës kërkimore shkencore dhe për regjistrimin e saj si shpikje pranë DPPI-së,
- Prodhuesit vendës për evidentimin dhe regjistrimin e produkteve karakteristike shqiptare si tregues gjeografikë.
-Bizneset në përgjithësi për evidentimin dhe regjistrimin e disenjove industriale.
- Edukimi i gjeneratave dhe brezave nëpërmjet aktiviteteve promovuese dhe ndërgjegjësuese në fushën e pronësisë industrial

Synohet mbi të gjitha vullnet e përgjegjshmëri nga të gjithë për të zbatuar me përpikëri ligjin, do të jenë një garanci më shumë që Shqipëria ta hedhë prapa krahëve problemin e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, në të njëjtin nivel me atë të BE-së.

Shërbimet e DPPI-së po shkojnë drejt standardeve bashkëkohore për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian, ashtu siç është e përcaktuar qartë në Marrëveshjen e Asociim-Stabilizimit (neni73 i saj).

## IV. BAZA LIGJORE MBËSHTETËSE E KËTIJ PROJEKT BUXHETI

Aktiviteti i DPPI përcaktohet dhe rregullohet nga Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008 "*Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar,* dhe rregulloret në zbatim të tij.

Gjithashtu, DPPI bazohet në konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare më të rëndësishme mbi Pronësinë Intelektuale që Shqipëria ka nënshkruar si:

- Konventa e Parisit "*Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale*", e miratuar në Paris më 20 Mars 1883-hyrë në fuqi në Shqipëri më 4 Tetor 1995;

- Ligj Nr. 8993, datë 30.1.2003 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale*" - hyrë në fuqi në Shqipëri më 30 Qershor 1992.

→ **Për mbrojtjen e Patentave për Shpikjet:**

- Ligji Nr. 9031, datë 20.3.2003 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin e Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave, për qëllime të procedurës së patentave*" – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 19 Shtator 2003;
- Ligji Nr. 9532, datë 15.5.2006 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen e Strasburgut për klasifikimin ndërkombëtar të patentave, 1979*" – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 24 Korrik 2007;
- Ligji Nr. 10180, datë 29.10.2009 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale*" (WIPO) – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 17 Maj 2010;
- Ligji Nr. 10179, datë 29.10.2009 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Evropiane të Patentave*" – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 1 Maj 2010;
- Ligji Nr. 118/2013, datë. 18.04.2013 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Londrës për zbatimin e Nenit 65 të Konventës për Patentat Evropiane*".

→ **Për mbrojtjen e Varieteteve Bimore**

Ligji Nr. 9395, datë 12.5.2005 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve*" – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 15 Tetor të vitit 2005.

→ **Për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës**

- Ligj nr. 66/2018 datë 24.9.2018 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë*".
- Ligj nr. 90/2018, datë. 03.12.2018 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar*".

→ **Për mbrojtjen e Disenjove Industriale**

- Ligji Nr. 9648, datë 27.11.2006 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale, 1960*" – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 19 Mars 2007;
- Ligji Nr. 9647, datë 27.11.2006 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës, 1999*".

- Ligj Nr. 33/2018, dt. 7.6.2018, *"Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Lokarnos "Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për disenjot industriale".*

→ **Për mbrojtjen e Markave Tregtare**

- Marrëveshja e Madridit e datës 14 prill 1891 "*Për regjistrimin ndërkombëtar të markave*" - hyrë në fuqi në Shqipëri më 4 Tetor 1995;
- Ligji Nr. 8992, datë 30.1.2003 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Protokollin e marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave*" – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 30 Korrik 2003;
- Ligji Nr. 9033, datë 20.3.2003 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Nicës për klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, për qëllimet e regjistrimit të markave*" – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 19 Shtator 2003
- Marrëveshje me Organizatën Botërore të Tregtisë (WTO);
- Marrëveshja e TRIPS-it (Aspekte të Tregtisë që lidhen me Pronësinë Intelektuale) – 08.09.2000.
- Ligj nr. 34/2018, dt. 7.6.2018 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës "Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare.*"

→ **Akte të tjera ligjore dhe nënligjore, që lidhen me fushën e zbatimit të mbrojtjes së pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.**

- Ligji nr. 9590 datë 27.07.2006 "*Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare*".
- Kodi penal i Republikës së Shqipërisë.
- Kodi civil i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji Nr.9863, datë 28.1.2008 "*Për ushqimin*"
- Ligji NR. 9901, datë 14.4.2008, "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", të ndryshuar
- Ligji Nr. 9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë".*
- Ligji Nr. 106/2016 "*Për prodhimin biologjik,etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre*".
- VKM Nr. 463, datë 5.7.2006 "*Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit*".
- Vendim Nr. 1058, datë 23.12.2015 Për Miratimin e Rregullit Teknik "*Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile*".

- VKM Nr. 1344, datë 10.10.2008 “*Për miratimin e rregullave për etiketimin e mallrave ushqimore”*
- Ligj Nr. 9591, datë 27.7.2006 Për ratifikimin e "*Marrëveshjes së Përkohshme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar*".
- VKM Nr. 299, datë 8.4.2015 “*Për Miratimin e Rregullorespër dhënien e autorizimit tëtregtimit të barnave e tëklasifikimit të tyre nëRepublikën e Shqipërisë*”.
- Ligji Nr .9199, datë 26.2.2004 “*Për prodhimin, perpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio*".
- Ligji Nr. 10 433, datë 16.6.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”.
- Ligj Nr. 9474, datë 09.2.2006 “*Për ratifikimin e konventës kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë "Për kontrollin e duhanit*".

Ky projekt buxhet është përgatitur në zbatim të nenit 191/b të ligjit Ligjit 9947, datë 07.07.2008, “*Për Pronësinë Industriale*”, i ndryshuar, sipas së cilit:

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.
2. Veprimtaria e DPPI-së financohet nga të ardhura të krijuara nga kryerja e veprimtarisë së saj në zbatim të këtij ligji dhe nga burime të tjera të ligjshme. Të ardhurat që DPPI realizon, sipas këtij ligji, por të pashpërndara në fund të vitit, derdhen në Buxhetin e Shtetit, me përjashtim të:
a) fondeve të parashikuara për investime;
b) pagesave të menjëhershme për llogari të institucioneve ndërkombëtare të fushës, sipas të cilave Republika e Shqipërisë ka detyrime financiare.
3. DPPI ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet të administrojë asetet e llogaritë e saj bankare pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Në këtë projekt buxhet investimet kapitale janë parashikuar në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025**.

## V. TREGUESIT KRYESORË TË BUXHETIT PËR VITIN 2023

*Në bazë të pikës 1 të nenin 191/a, të Ligjit 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Indsutriale", i ndryshuar*, të ardhurat që realizon DPPI-ja janë:

**Të ardhurat që realizon DPPI janë:**
a) të ardhurat që krijohen nga aktiviteti i saj;
b) të ardhurat nga tarifat e Sistemit të Madridit për regjistrimin e markave ndërkombëtare, e Marrëveshjes së Hagës për aplikimet ndërkombëtare për disenjo industriale, si dhe të gjitha marrëveshjet e tjera që Republika e Shqipërisë ka lidhur ose do të lidhë në fushën e pronësisë industriale;
c) të ardhura të tjera që mund të krijohen sipas legjislacionit në fuqi.

**Shpenzimet që realizon DPPI:**
*Në zbatim të pikës 3 të nenit 191/a, të Ligjit 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar*, në shpenzime përfshihen fondet e shpenzuara për paga, sigurime, shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, aktivitete të ndryshme në fushën e pronësisë industriale, brenda dhe jashtë vendit, të gjitha këto të nevojshme për ushtrimin dhe realizimin e funksioneve të DPPI-së, si dhe për pagesat e kontributeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të PI-së.

*Në zbatim të pikës 2(a) dhe 2(b), të nenin 191/b të Ligjit 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar:*

a) Fondet e parashikuara për investime;
b) Pagesat e menjëhershme për llogari të institucioneve ndërkombëtare të fushës,
sipas të cilave Republika e Shqipërisë ka detyrime financiare,
c) Fondet të cilat janë të pashpërndara në fund të vitit, transferohen për vitin pasardhës.
Si të tilla janë të reflektuara në projektbuxhetin e vitit 2023, fondet në zbatim të këtij neni.

### V.1 TË ARDHURAT E PARASHIKUARA PËR PERIUDHËN 01 JANAR – 31 DHJETOR 2023

**Të ardhurat**për periudhën 01 Janar – 31 Dhjetor 2023në buxhetin e DPPI-së parashikohen të jenë në vlerën ***202 milionëlekë***duke përfshirë të ardhurat nga aktiviteti kryesor, të ardhura nga Marrëveshja e Madridit, Marrëveshja e Hagës dhe nga Marrëveshja e shtrirjes së patentave europiane me EPO.Duke i shtuar edhe trashëgimin e

investimeve të parealizuara dhe të parashikuara në një shumë prej ***93 milionë lekë***, **në total** zëri i të ardhurave për vitin 2023 arrin shumën***295 milionëlekë***.

Tabela më poshtë tregon zërat e të ardhurave me parashikimet per vitin 2023 si dhe fondet e trashëguara nga viti 2022, të cilat paraqiten te investime dhe projektet ne vazhdim:

| | | **PLAN Viti 2023** |
|---|---|---|
| **A. KL.7** | **TE ARDHURAT** | **000/lekë** |
| **1** | Aktivitet Kryesor, regjistrim, administrim, promovimi objekteve të PI. | 135.000 |
| **2** | Të trashëguara, investime dhe projekte ne vazhdim. | 92.769 |
| **3** | Marreveshja e Madridit. | 66.000 |
| **4** | Marreveshja e Hages. | 1.000 |
| **5** | Te ardhura nga marreveshja e shtrirjes e patentave europiane me ZEP (EPO). | 100 |
| | **TOTALI I TË ARDHURAVE** | **294.869** |

***<u>Të ardhurat nga aktiviteti kryesor i DPPI-së</u>*** **janë parashikuar 135*milionë*lekë**. Konsistojnë në të ardhurat e arkëtuara nga tarifat e shërbimeve të parashikuara në vendimin nr.316,datë 31.05.2018, të Këshillit të Ministrave, "*Për disa ndryshime dhe shtesa nr.883, datë 13.05.2009, "Për Miratimin e Tarifave për Regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale*", i ndryshuar.

Grupimet kryesore të tarifave sipas shërbimeve që ofron DPPI janë:

- Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me patentat e shpikjeve;
- Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me certifikatat e mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore dhe produktet për mbrojtjen e bimëve;
- Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me modelet e përdorimit;
- Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur disenjot industriale;
- Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me markat tregtare dhe të shërbimit;

- Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me treguesit gjeografikë;
- Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me qarqet e integruara;
- Tarifat për shërbime të tjera të kryera pranë DPPI.

***Të ardhurat nga Sistemi i Madridit*****janë parashikuar 66*****milionë*****lekë**.

Këto janë të ardhurat e arkëtuara nga aplikimet e markave ndërkombëtare sipas Marrëveshjes së Madridit dhe Protokollit të Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave. Këto aplikime dhe pagesa bëhen në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale. Kur aplikanti vendos të zgjedhë Shqipërinë si vend që do të regjistrojë markën e tij, atëherë aplikimi dhe pagesa i dërgohet DPPI, në zbatim të bazës ligjore. Kjo vlerë e parashikuar është llogaritur bazuar në faktin e aplikimeve dhe koeficientin e llogaritjes të derguar nga OBPI me kërkesën e DPPI.

***Të ardhurat nga Marrëveshja e Hagës*****janë parashikuar 1*****milionë*****lekë.**
Këtojanë të ardhurat e arkëtuara nga aplikimet e markave ndërkombëtare sipas Marrëveshjes së Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale.Këto aplikime dhe pagesa bëhet në Organizatën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale. Kur aplikanti vendos të zgjedhë Shqiperinë si vend që do të regjistrojë markën e tij, atëherë aplikimi dhe pagesa i dërgohet DPPI, në zbatim bazës ligjore.

***Të ardhurat nga marrëveshja e shtrirjes së patentave me ZEP*****janë parashikuar 0.1** ***milionë*****lekë.**

Ky zë i të ardhurave është në zbritje dhe pritet të shkojë në zero. Kjo për faktin se që prej datës 1 Maj 2010, Shqipëria është vend anëtar i Zyrës Evropiane të Patentave (ZEP). Aplikimet e depozituara në ZEP pas kësaj date trajtohen në zbatim të Konventës Evropiane të Patentave e cila nuk parashikon transferim të tarifës së grumbulluar nga ZEP. Këtë tarifë DPPI e ka parashikuar ta grumbullojë në fazën e aplikimit pranë DPPI dhe konsiderohet si e ardhur nga aktiviteti kryesor.
Pagesa që transferohet në llogarinë e DPPI-së është vetëm për aplikimet që janë depozituara në ZEP para datës 1 Maj 2010, por që nuk ka përfunduar ende ekzaminimi dhe që nuk janë publikuar.

***Të trashëguara, investime dhe projekte ne vazhdim.janë transferuar në vlerën 93milionë lekë.***

Diferenca e pashpërndarë (të trashëguara) në fund të vitit 2022, në *bazë të gërmës a të pikës 2, të nenit 191/b , të Ligjit 9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, transferohet në buxhetin e vitit 2023, për zbatimin e projekteve të parashikuara në vazhdim.* Vlera e projektit të AKSHIT mbështetet në shkresën Nr. 3129 prot., datë 26.05.2022, administruar në DPPI me Nr. 489 prot., datë 30.05.2022, në të cilën është shprehur vlera e implementimit të projektit për vitin 2023. Vlera totale e projektit të AKSHIT është e përbërë nga vlera e trashëguar e vitit 2022 ku përfshihet edhevlera e alokuar nga "Shpenzime personeli ne "Shpenzime kapitale" sipas V.K.M Nr. 886, date 27.12.2022 "*Për një ndryshim në Vendimin nr. 34, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2022*", vlera e parashikuar për vitin 2023

## V.2SHPENZIMET E PARASHIKUARA PËR PERIUDHËN

## JANAR- DHJETOR 2023

→ **Shpenzimet**për vitin 2023 janë parashikuar për shpenzime personeli, shpenzime operative dhe korrente, transferime korrente të brendshme, transferime korrente jashtë dhe shpenzime kapitale, duke pasur parasysh prioritetet e përcaktuara nga DPPI në objektivat e vitit 2023.
Gjithashtu janë marrë parasysh edhe angazhimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025, si dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) neni 73 i saj "*Të drejtat e Pronësisë Intelektuale*", si dhe zbatimi i planit kombëtar për integrimin evropian PKIE 2023-2025.
Në parashikimin e shpenzimeve për 2023 një hapësirë të konsiderueshme zënë edhe aktivitetet e Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës.

Në kuadër të realizimit të objektivave, DPPI organizon takime, tryeza të rrumbullakëta, trajnime me studentë të universiteteve të ndryshme, magjistraturën, gjyqtarë, punonjës të QKB dhe Dhomave të Tregtisë në të gjitha rrethet e vendit.

- **Në total shpenzimet janë planifikuar280 *milionë*lekë** sipas zërave më poshtë:

| KL. | SHPENZIMET | 000/lekë |
|---|---|---|
| **B.600** | ➢ Shpenzime personeli | 55.821lekë |
| **B.438** | ➢ Të tjera detyrime (rimbursime) | 3.918 lekë |
| **C.602** | ➢ Shpenzime operative dhe korrente | 21.798lekë |
| **F.605** | ➢ Transferta korrente në organizma ndërkombetare | 90.000 lekë |

| TOTALI I SHPENZIMET | 171.537lekë |
|---|---|

→ ***Shpenzimet kapitale***(shuma e transferuar nga viti 2022 plus projekte të reja)të vitit 2023janënë vlerën **123*milionë*lekë**.

Këtë planifikim e kemi mbështetur në vlerën e projekteve "*Për përmirësimin e sistemit të menxhimit të informacionit për DPPI*"(AKSHI), "*Për identifikimin dhe nxitjen e regjistrimit të produkteve potenciale për t'u mbrojtur si tregues gjeografik*", si dhe "*Projektin mbi rritjen e ndërgjegjësimit tek brezat e rinj dhe stafet pedagogjike, të ciklit të ulët dhe të mesëm*". Këto projekte janë të parashikuara edhe në Strategjinë e Pronësisë Intelektuale 2022-2025. Projekt i ri është "*30 Vjetori i DPPI-së*".

Tabela më poshtë përmbledh investimet e trasheguara dhe te reja vitin 2023:

| Nr. | Investime te parashikuara | Te trasheguara dhe te miratuara ne vitin 2022 | Te parashikuara per vitin 2023 | Totali i Investimeve 000/lekë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mbrojtje ndaj zjarrit | 4* | | |
| 2 | Orendi zyre | 120* | | |
| 3 | Korrektimi gjuhesor | 48* | | |
| 4 | Pajisje kompjuterike | 242* | | |
| 5 | Projekt mbi studimin, identifikim dhe nxitjen e rregjistrimit te Treguesve Gjeografik | | 3,000 | 3,000 |
| 6 | Studim, indetifikimi dhe nxitja e regjistrimit te disenjove industrial shqiptare,Studim, indetifikimi dhe nxitja e regjistrimit te markave te sherbimit | 23* | | |
| 7 | Dy Projekte ne Vleren 960,000 secili | 1,920* | | |
| 8 | (Projekti ALSIP- SHQIPERI) TVSH - Riemertohet Projekti per 30 vjetorin | 6,000 | | 6,000 |
| 9 | AKSHI | 77,080 | 27,563 | *107,000 |
| 10 | Projekt mbi rritjen e ndërgjegjësimit tek brezat e rinj dhe stafet pedakogjikë të ciklit të ulët dhe të mesëm | 6,000 | | 6,000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **11** | Kosto mirembajtje per programet e ndryshme te DPPI-se | 132 | | 132 |
| **12** | Nderlidhja e web nga projekti twinning | 1,200 | | 1,200 |
| | **TOTALI** | **92,769** | **30,563** | **123,332** |

Vlera e projektit të AKSHIT mbështetet në shkresën Nr. 3129 prot., datë 26.05.2022, administruar në DPPI me Nr. 489 prot., datë 30.05.2022, në të cilën është shprehur vlera e implementimit të projektit për vitin 2023. Vlera totale e projektit të AKSHIT është e përbërë nga vlera e trashëguar e vitit 2022 ku përfshihet edhevlera e alokuar nga "Shpenzime personeli ne "Shpenzime kapitale" sipas V.K.M Nr. 886, date 27.12.2022 "*Për një ndryshim në Vendimin nr. 34, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2022*", vlera e parashikuar për vitin 2023 dhe si dhe vlerën e trashëguar nga projekte të tjera (tepricat e investimeve), si më poshtë:

000/lekë

| Nr. | Investime te parashikuara | Te trasheguara dhe te miratuara ne vitin 2022 | Shenim |
|---|---|---|---|
| **1** | Mbrojtje ndaj zjarrit | 4 | *Vlera prej 16,356,800 lekësh e trashëguar nga viti 2022 do të transferohet për projektin e AKSHIT. |
| **2** | Orendi zyre | 120 | |
| **3** | Korrektimi gjuhesor | 48 | |
| **4** | Pajisje kompjuterike | 242 | |
| **6** | Studim, identifikimi dhe nxitja e regjistrimit te disenjove industrial shqiptare,Studim, indetifikimi dhe nxitja e regjistrimit te markave te sherbimit | 23 | |
| **7** | Dy Projekte ne Vleren 960,000 secili | 1,920 | |
| **8** | Fonde të alokuara nga "Shpenzime personeli"ne "Shpenzime kapitale"sipas V.K.M Nr. 886, date 27.12.2022 | 14,700 | |
| | **TOTALI*** | **16,357** | |

| KL. | SHPENZIME KAPITALE | 000/lekë |
|---|---|---|
| G.231 | ➢ Shpenzime Kapitale të Trupezuara | 0 lekë |
| I.230 | ➢ Shpenzime Kapitale të Patrupezuara | 123.332 lekë |
| | TOTALI I SHPENZIMET KAPITALE | 123.332lekë |

## → ***TË TJERA DETYRIME (RIMBURSIME)***

Në projektbuxhetin e vitit 2023 janë parashikuar janë parashikuar në vlerën ***3.9milionë lekë*** sipas zërave të mëposhtëm:

| B. Kl. 4 | TE TJERA DETYRIME | 000/lekë |
|---|---|---|
| 4381000 | **Te tjera detyrime, Te vitit ne vazhdim (2023)** | 0 lekë |
| 4382000 | **Te tjera detyrime, Te vitit te meparshem(2022)** | 1,740 lekë |
| 4383000 | **Te tjera detyrime, Te viteve te meparshme(2020+2021)** | 2,178 lekë |
| | TOTALI I TE TJERA DETYRIME | **3,918 lekë** |

Baza ligjore:

Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë*”, neni 118 pika 1 “*Të gjitha pagesat apo kontributet, të cilat tashmë janë paguar nga pala dhe/ose nga organi publik, në bazë të një akti të anuluar, duhet të kthehen*”.

V.K.M Nr.1707, datë 29.12.2008 “*Për miratimin e rregullores “Për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit*”, i ndryshuar, pika 3.6, Kreu XVI, “*Kur pagesa është kryer, por regjistrimi nuk mund të ripërtërihet ose është ripërtërirë si pasojë e një pagese tjetër, kjo pagesë do të rimbursohet nga zyra*”.

V.K.M Nr. 315, datë 31.5.2018 “*Për miratimin e rregullores për markat*”, i ndryshuar, neni 18, pika 2 “*Nëse kërkesa për dorëheqje nga aplikimi bëhet para se sa zyra të ketë filluar ekzaminimin formal të aplikimit, sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje, zyra i kthen aplikantit 80% të shumës së paguar në momentin e aplikimit*” dhe neni 36, pika 15 “*Kur pagesa është kryer, por kërkesa për ripërtëritje refuzohet nga zyra, kjo pagesë rimbursohet në masën 80% kundrejt një kërkese me shkrim të aplikantit ose përfaqësuesittë tij*”.

Vlerat e mësipërme janë llogaritur bazuar në kërkesat e Përfaqësuesve të Autorizuar të cilët kërkojnë rimbursimin e pagesave.

→ **<u>SHPENZIME PERSONELI</u>**

Në projektbuxhetin e vitit 2023 janë parashikuar ***shpenzime për personelin 56 milionë lekë***sipas zërave te mëposhtëm.

**Pagat e punonjësve të administratës janë parashikuar *39 milionë lekë*.**
Në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të DPPI-së, nr 3 prot, datë 10.07.2018, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale*", numri i punonjësve organikëështë 39.
Llogaritjet janë bërë në bazë të Lidhjes Nr.1 të rritjes së pagave të administratës me Vendim Nr. 621, datë 28.9.2022 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar*" sipas së cilës paga e Drejtorit të Përgjithshëm hyn në kategorinë II-a, Drejtor Drejtorie në kategorinë III-a, Përgjegjës Sektori III-a/1 Specialist IV-a.

Për specialistët e ekzaminimit është caktuar një shtesë për punë të veçantë në vlerën 10,000lekë/muaj në bazë të VKM nr. 116, datë 23.02.2018.

Për stafin mbështetës llogaritjet janë bërë në bazë tëVendimit Nr. 627, datë 28.9.2022 "*Për disa ndryshime në Vendimin nr. 234, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave,* "*Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike*"dhe konkretisht, Sekretar titullari sipas kategorisë VIII,Arkiv/Protokoll Kategorisë VII, Shofer kategorisë IV.

**Pagat e punonjësve me kontratë me kohë të kufizuar janë parashikuar2*.5 milionë* lekë.**

Për vitin 2023 është parashikuar kontraktimii punonjësve me kohë të pjesshme mbi numrin organik të punonjësve të institucioneve buxhetore.

Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme në strukturën e DPPI-së,është kryesisht në veprimtari e njësivestrukturore mbështetëse/rregullatore/shërbimi të institucionit.

Në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse janë parashikuar 4 (katër) punonjës me kontratë ku përfshihen:

1. 1(Teknik)- 6 (gjashtë) orë në ditë për 12 ( dymbëdhjetë) muaj me kategorinë VI.
2. 1(Sanitare) - 6 (gjashtë) orë në ditë për 12 ( dymbëdhjetë) muaj me kategorinë I.

Këta punonjës janë të rëndësishëm të jenë pjesë e stafit pasi shërbejnë për kontrollin dhe mbarëvajtjen e magazinës si dhe për mirëmbajtjen e ambjentit të godinës së DPPI-së duke mundësuar kushtet optimale të higjenës.

3.Gjithashtu, në DPPI mbështetur në ligjin nr.9154 date 06.11.2003 "*Për arkivat*" lidhur me procesin e përpunimit tekniko - shkencor të dokumenteve pranë sekretari-arkivit për vitet 1998-2000 kërkon një asistencë metodologjike lidhur me përpunimin e dokumenteve 1998-2000.
1(Arkivist) – 6 (gjashtë) orë në ditë për 12 ( dymbëdhjetë) muaj me kategorinë VI.
1 (Punonjes me kontrate) 6 (gjashtë) orë në ditë për 12 ( dymbëdhjetë) muaj me kategorinë IV-b.

4. Në vijim të procesit të punës mbi rritjen e cilësisë së ekzaminimit dhe duke ofruar një shërbim sa më të shpejtë dhe cilësor nëpërmjet Drejtorisë së Ekzaminimit, e cila është në shërbim të drejtpërdrejtë të nevojave të subjekteve tregtare vendase dhe të huaja nevojitet shtesë1 (një) punonjës me kohë të kufizuar 6 orë për 12 muaj me kategorinë IV/a.

5. Sektori i pritjes dhe informacionit ku konsiston puna e shtuar, ka mungesë stafi nga 5 punonjës në strukturë, aktualisht janë të punësuar vetëm 4. Këtu nevojitet 1 (një) punonjës me kohëzgjatje 6 orë për 12 muaj me kategorinë IV/a.

Mosfunksionimi i platformës e-albania për afro një muaj e krijoi vështirësi në menaxhimin e punës në Drejtori. Për këtë arsye dokumentacioni po përcillet me shumë vonesë si tek ekzaminuesit ashtu edhe tek aplikantët.
Këto vonesa shkaktuan grumbullimin e aplikimeve duke sjellë edhe zgjatjen e procesit të ekzaminimit.

**Detyrimet për sigurime shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale**të punonjësve të administrates dhe të punonjësve me kontratë me kohë të kufizuar janë parashikuarnë shumën ***14.3 milionë lekë***.

Tabela e mëposhtme jep edhe njëherë në mënyrë të përmbledhur zërat e shpenzimeve të personelit:

| B.600+601 | SHPENZIME PERSONELI (mijë lekë) | 000/lekë |
|---|---|---|
| **1001** | Paga e administratës | 39,000 lekë |
| **2100** | Paga me kontratë për kohë të kufizuar | 2,521 lekë |
| **0000** | Sigurime Shoqërore , Shëndetësore | 14,300 lekë |

| **SHUMA** | **55,821** lekë |
|---|---|

→ **SHPENZIME KORRENTE DHE OPERATIVE**

***Shpenzimet korrente për vitin 2023 janë parashikuar në vlerën 26 milionë lekë.***

Ato janë parashikuar në përputhje me kërkesat për mjete logjistike dhe administrative që vijnë në mbështetje të DPPI-sëpër realizimin e objektivave të saj, si dhe bazuar në konsumin faktik të vitit të kaluar.

***Kancelari*** janëparashikuar **0.2*milionë*lekë**. Në bazë të konsumit faktik të vitit të kaluar që kanë pasur kancelaritëdhe duke marrë në konsideratë kapacitetet administrative është parashikuar kjo shumë për të mbuluar nevojat si dhe kërkesat e dërguara nga sektorët dhe drejtoritë e DPPI-së. Në këtë zë përfshihet blerja e *dosjeve specifike* për ekzaminimin e objekteve të PI (marka, patenta,disenjo industriale, tregues gjeografike)të cilat janë lehtësisht të menaxhueshme nga stafi,blerja e letrës, lapsa, stilolapsa, letër A4, zarfa, si dheartikuj të imët zyre, etj. Kjo kërkesë bazohet edhe në natyrën e punës së DPPI-së e cila nxjerr një numërtë konsiderueshëm dokumentash (rreth 12,000 dok/vit)

***Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje, ndriçim*** janë parashikuar **0.2 *milionë* lekë** nëbazë të konsumit nga stafi i DPPI, si dhe me qëllim krijimin e kushteve sa mëtë përshtatshmehigjeno-sanitare të ambjenteve ku punon stafi (zyrat, magazina,arkiva, protokolli).

***Materiale përfunksionimin e pajisjeve të zyrës, bojë printer*** është parashikuar **1.2*milionë*lekë.**Theksojmë edhe njëherë se DPPI nxjerr nje numër të konsiderueshëm dokumentash (rreth 12,000–13,000 dok/vit), si dhe duke ardhur si pasojë e digjitalizimit të punës.Gjithashtu kjo vlerëështë nxjerrëduke patur parasysh konsumin e vitit të kaluar.Gjithashtu vlen tëpërmendim edhe printimetme ngjyrë të certifikatave nga sektori i ekzaminimit si dhe sektori pritjes për printime të cilat janë të shumta.

***Libra dhe Publikime profesionale***janë parashikuar***0.25 milionëlekë***
Në kuadër të promovimit,jo vetëm të objekteve të PI-së, por dhe për të promovuar shpikjet e reja që shtetasit Shqiptarë kanë kryer dhe në kuadër të promovimit të bizneseve si dhe nevojat e përgatitjes, botimit dhe shumë-fishimit të Raportit Vjetor sipas përmasave të caktuara.

Shpenzimet janë llogaritur bazuar në eksperiencat si dhe shpenzimet e mëparshme të DPPI të këtij lloji etj.

***Konsulenca, spote publicitare dhe përkthime*** janë parashikuar***3milionë lekë.***

Nëparashikimin e bërëpër këtë zë, pjesën mëtë madhe e zënë spotet publicitare. Duke qenë se promovimi është një nga dy shtyllat kryesore të ligjit 9947 “*Për Pronësinë Industriale*”, mbetet detyrë e DPPI-së organizimi i fushatave publicitare me qëllim promovimin e kësaj fushe si mjet i rëndësishëm për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e subjekteve. Nëpermjet promovimit dhe spoteve publicitare DPPI ndikon drejtpërdrejtë tek subjektet e interesuara për të aplikuar për mbrojtjen e objekteve të tyre të PI-së, të cilat përkthehen në rritje të të ardhurave të drejtorisë.Spotet publicitare përfshijnë edheorganizimet me rastin e ditës botërore të pronësisë intelektuale.Parashikimet janë bërënë bazë të kontratave të mëparshme si dhe çmimeve të tregut. Nisur nga eksperienca dhe metodologjia e deritanishme e kompanive dhe organizatave të ndryshme shfaqja e spoteve publicitare me karakter informues për pronësinë industriale është një mënyrë shumë efikase për promovim.
Në përmbushje të nenit 191/c të ligjit 9947, DPPImerr konsulencë në fushën e certifikimit dhe auditimit financiar të bilancit të DPPI. Gjithashtu lind nevoja edhe për ekspertiza të tjera në realizimin e investimeve/shërbimeve, në rastet kur DPPI nuk ka ekspertë të fushës. Kërkesa ka edhe nga Njesia e Prokurimit për prokurime të vecanta ku nevojitet prezenca e ekspertit të fushës.
Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka parashikuar një reformë të plotë ligjore në fushën e Pronësisë Industriale e cila do të ketë si objekt ndarjen e objekteve të pronësisë industrial në ligje të vecanta si prsh;
Ligji për market tregtare;
Ligji për patentat dhe modelet e përdorimit;
Ligji për disenjot industriale dhe
Ligji për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës;
Në lidhje me përmirësimin e kuadrit ligjor mund të theksohet se ky proces përfshin dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
Gjithashtu kjo reformë është parashikuar dhe në PKIE dhe në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025.
Duke qenë se ky proces kërkon një punë shumë të madhe e të papërballueshme vetëm nga stafi në përgatitjen e plotë të çdo paketë ligjore (projektligj, RIA, relacion shpjegues, tabela përafrimi) kërkohet që të ndiqet nga studio ligjore të cilat kanë eksperincë në hartim legjislacioni. Gjatë vitit 2023 janë parashikuar 2 projekt-ligje Ligji për disenjot industriale dheLigji për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, të cilët kanë një kosto përafërsisht 2.600.000 lekë.

Gjithashtu në këtë zë janë parashikuar përkthimetë akteveligjore dhe nënligjore të reja,si detyrim që kemi ndaj përfaqësuesve të huaj të cilët aplikojnëpranë zyrave të DPPI-së.Gjithashtu përkthim kërkojnë edhe manuale të ndryshme apo materiale për qendrën e trajnimeve.

***Shpenzime për energji elektrike*** janë parashikuar ***2milionë lekë***bazuarnë konsuminmujor, si dhe në rritjen e çmimit të energjisë si pasojë e krizës globale energjitike.

***Shpenzime për ujë*** janë parashikuar ***0.5 milionëlekë*** bazuar në Akt-marrëveshjen e Bashkëpunimit Ndërinstitucionalme QKB.

***Shpenzime postë, telefon, celular***, janë parashikuar **0.7 *milionë*lekë**bazuar në konsumin mujor.

***Shërbime bankare*** janë parashikuar **0.15 *milionë* lekë**. Duke qenë se DPPI administron fondet e saj pranë një banke të nivelit të dytë lind nevoja e parashikimit të këtij fondi për të përballuar komisionetbankare gjatë marrjes së shërbimeve tëndryshme.

***Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes*** janë parashikuar në shumën **4*milionë* lekë**. Në këtë zë përfshihet lidhja e kontratës më Illyrian Guard sh.a për të mundësuar shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike.

***Shpenzime transporti***janë parashikuar ***0.9 milionë lekë***. Përbëhen nga shpenzime për karburant, vaj, siguracion, pjesë këmbimi, goma, bateri dhe shpenzime të tjera.Kjo vlerë është parashikuar bazuar edhe në kërkesën në rritje të numrit të aktiviteteve promovuese dhe trajnuese në të gjithë territorin e Shqipërisë.Gjatë vitit 2023 janë parashikuar vetëm nga Stategjia Kombetare e Pronesise Intelektuale kryerja e një sërë aktivitetesh në të gjitha pikat doganore, deget rajonale të QKB-së, ADISA, biznese të ndryshme si dhe aktivitetet me Institucione të tjera jashtë Tiranës.

***Shpenzim për udhëtime e dieta brenda vendit,*** janë parashikuar në shumën ***1milionëlekë.*** Bazuar në pikën 1, të nenit 193/d, të ligjit nr. 9947, datë 7.07.2008, "*Për Pronësinë Industriale*", i ndryshuar, Qendra e Trajnimeve organizon aktivitete, kurse, trajnime dhe seminare nëfushën e PI-së, me qëllim ndërgjegjësimin e subjekteve në lidhje me fushën.
Gjithashtu, në kuadër të "*Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025*", miratuar me VKM nr.350, datë 26.5.2022, DPPI duhet të kryejë një sërë trajnimesh për subjektet e parashikuara në Strategji, jo vetëm brenda Tiranës, por edhe në rrethe, si më poshtë:

1) Organizimi i trajnimeve të stafit të qendrave të informimit,

2) Organizimi i takimeve me Dhomat e Tregtisë në rrethe,

3) Leksione dhe sesione informimi, apo tryeza të rrumbullakta në universitete ose shkollat e arsimit parauniversitar jashtë Tiranës,

4) Takime në lidhje me identifikimin e treguesve gjeografik në zonat potenciale të Shqipërisë,

5) Organizimi i takimeve me biznese të ndryshmenë rrethe për qëllimin e promovimit të PI-së.

**I. *<u>Subjektet të cilët duhet të trajnohen mbi fushën në përgjithësi si dhe për mallrat pirate e të fallcifikuara në veçanti janë:</u>***

1. Trajnim në Doganën e Muriqanit
2. Trajnim në Doganën e Kapshticës;
3. Trajnim në Doganën e Kakavijës;
4. Trajnim në Doganën e Qafë Thanës;
5. Trajnim në Doganën e Morrinës;
6. Trajnim në Doganën e Pogradecit;

**II. *<u>Trajnime në rrethe në lidhje me fushën e PI-së dhe rëndësinë e regjistrimit të objekteve të PI-së pranë bizneseve në rrethet e mëposhtme:</u>***

Organizimi i aktiviteteve promovuese dhe trajnuese për mbrojtjen dhe regjistrimin e TG të organizuar sipas rretheve: Gjirokastër, Tepelenë, Elbasan, Vlorë, Malësia e Madhe etj. Aktivitetet për secilin nga këto rrethe janë të parashikuara si shembulli i aktiviteteve për rrethin e Gjirokastrës dhe Përmetit. Analiza do të jetë baza për evidentimin e rëndësisë për aktivitete ndërgjegjësimi në rrethe të tjera të Shqipërisë.

**III. *<u>Trajnime në lidhje me përfitimin e patentës si dhe të kuptojmë se kur jemi në kushtet e shpikjes:</u>***

DPPI ka krijuar disa Qendra Informative në universitetet teknike në Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Korçë, të pajisura me logjistikën e nevojshme, përfshirë stafin e trajnuar.

Theksojmë se është e nevojshme trajnimi i stafit pranë këtyre qendrave 2 herë gjatë vitit kalendarik. Trajnimet do të jenë në lidhje me përditësimet më të fundit të Sistemit të instaluar nga DPPI.

Sfidat për të ardhmen

- Ngritja e qendrave të transferimit të teknologjisë pranë Universiteteve.
- kurrikula e pronësisë intelektuale duhet të zhvillohet më tej në universitete, qoftë si një lëndë e vetme ose brenda lëndëve të tjera;
- personeli kërkimor duhet të marrë informacion mbi mundësinë e mbrojtjes së shpikjeve dhe krijimeve të tyre përmes të drejtave të pronësisë intelektuale;
- politikat intelektuale të zhvilluara në universitet janë zakonisht një mjet i mirë për përcaktimin e roleve, detyrave, të drejtave dhe përgjegjësive në projektet shkencore, mbrojtjen e rezultateve të tyre dhe komercializimin e rezultateve të kërkimit shkencor;
- përmirësimi i kërkimit shkencor duhet të çojë në më shumë patenta në universitete dhe më shumë transferim të teknologjisë.

***Shpenzime për udhëtim e dieta jashtë vendit***, janë parashikuar në shumën ***4milionëlekë.***

Natyra e punës që kryhet pranë DPPI-sëështë shumë specifike dhe e veçantë, e si e tillë stafi ka nevojë gjatë gjithë kohës për trajnim, të cilat i ofrojnë Organizatat Ndërkombëtare, pasi DPPI kryen ekzaminime ndërkombëtar të këtyre organizatave.
Trajnimi që ofrohet për stafin e DPPI është thelbësor për disa arsye:
1. Është fushë që nuk është as lëndë në fakultet dhe as nuk mund të haset në përditshmëri, pasi ka natyrë shumë specifike dhe të veçantë pune, e si e tillë stafi ka nevojë të vazhdueshëm për trajnim.
2. Sistemet që përdoren nga stafi i DPPI-së janë gjithë kohës në përditësim, pasi i përshtaten ndryshimeve ligjore të bëra herë pas here dhe ndryshimi i një program kërkon me patjetër trajnimin specific nga ekspertët ndërkombëtarë.
3. Sistemi që përdor stafi i DPPI-sëështë shumë specifik, pasi është një sistem i dhuruar nga WIPO (Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale) dhe janë pikërisht këta të *fundit që ofrojnë trajnime në lidhje me sistemin, pasi sistemi nuk mund të përdoret pa pasur njëherë trajnimin e nevojshëm prej tyre.*
*4. Trajnimi i stafit të DPPI-së nga Organizatat Ndërkombëtare të fushës është thelbësore, pasi duke mos ofruar një ekzaminim cilësor dhe në përputhje me standartet Evropiane, ul reputacionin e zyrës si dhe shkakton shume probleme në tregun ndërkombëtar, pasi zyrat homologe bëjnë shtrirje të regjistrimit të objekteve të tyre në fushën e PI-së pranë zyrës sonë.*

Në bazë të nenit 191/a, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, "*Për Pronësinë Industriale*", i ndryshuar citohet se:
*"Për projektet, aktivitetet apo investimet që zbatohen në kuadër të marrëveshjeve të lidhura nga DPPI-ja me institucione ndërkombëtare të fushës, të cilat investohen tërësisht me fondet e tyre apo pjesërisht edhe me fondet e DPPI-së, zbatohen procedurat*

*që ndjekin këto institucione ose procedurat që përcaktohen në marrëveshjet përkatëse të lidhura me këto institucione.”*

Sa më sipër si dhe në zbatim të Marrëveshjes që DPPI ka me Zyrën Evropiane të Patentave, DPPI duhet të mbulojë një pjesë të shpenzimeve për trajnimet që këta të fundit ofrojnë, kurse pjesa më e madhe mbulohet nga ZEP (EPO).

Përveç trajnimeve/ takimeve të mësipërm, në këtë zë buxheti duhet të parashikohen dhe mbulimet e shpenzimeve për tre përfaqësues nga DPPI në takimet e rradhës. Në korrik 2019 Shqipëria dhe Bashkimi Evropian mbajtën Konferencën e Parë Ndërqeveritare mes tyre në Bruksel që shënoi hapjen zyrtare të bisedimeve për anëtarësim të vendit tonë në Bashkimin Evropian. Për të qenë anëtar i Bashkimit Evropian, duhet që vendet kandidatë të përafrojnë legjislacionet e tyre përkatëse me atë të BE-së, i njohur ndryshe si “acquis communautaire”. Pranimi i “acquis communautaire” nga vendet anëtare është parakusht për aderimin e tyre në BE. Kjo gjë nënkupton përshtatjen e legjislacioneve kombëtare me normat e KE-së dhe zbatimin e tyre që në momentin e aderimit.Për këtë arsye takimet bilaterale pritet që të fillojnë në janar 2023.

***Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme***, janë parashikuar ***0.9 milionë lekë***.
Në të përfshihen:

- ***Shpenzime për mirembajtjen e pajisjeve të zyrave*** janë parashikuar***0.9 milionë lekë.***

Do tëpërdoren për riparimin e pajisjeve të zyrës, siç janë pajisjet kompjuterike, fotokopje, printera (duke marrë në konsideratë kërkesat e sektorëve). Duke qenë se DPPI ka një numer të madh printerash, fotokopjesh, kompjutera, UPS të cilat përdoren shumë nga stafi i ekzaminimit dhe sektorë të tjerëlind herë pas here nevoja për mirëmbajtjen e tyre.

Sic e kemi theksuar dhe më lart në zerat e tjere buxhetore, DPPI është institucion që prodhon mesatarisht 12,000-13,000 dokumente/vit dhe për këtë arsye edhe konsumi i pajisjeve është i madh.

***Shpenzime për qiramarrje ambientesh,*** janë parashikuar***1.6 milionë lekë***.
Bazuar në pikën 1, të nenit 193/d, të ligjit nr.9947, datë 7.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, Qendra e Trajnimeve organizon aktivitete, kurse, trajnime dhe seminare në fushën e PI-së, me qëllim ndërgjegjësimin e subjekteve në lidhje me fushën.
Gjithashtu, në kuadër të “Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025”, miratuar me VKM nr.350, datë 26.5.2022 si dhe në kuadër të “Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025, DPPI duhet të kryejë një sërë trajnimesh për subjektet e parashikuara në Strategji, që kanë lidhje me fushën, si psh:

1. Trajnim për doganierët;
2. Trajnim për Inspektoriatin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut;
3. Trajnim për shkollat 9 vjeçare, gjimnazet si dhe Universitetet;
4. Trajnim për Përfaqësuesit e Autorizuar;
5. Trajnim per Magjistratët;
6. Trajnim për bizneset në mënyrë që të ndërgjegjësohen për rëndësinë e markës së tyre dhe patentës, nëse kanë.

Trajnimi varion në sajë të grupit të interesit, por temat kryesore janë:
1. Njohuri të përgjithshme në fushën e PI-së.
2. Si të përfitojmë njëpatentë;
3. Si të jemi pronarë të markës sonë;
4. Plotësim i formularëve për markat tregtare (trajnim për përfaqësuesit e autorizuar)etj.

Për vitin 2023, DPPI ka planifikuar aktivitete me qëllim promovimin tek Qendra e Trajnimeve për zhvillimin e gjithë këtyre trajnimeve të parashikuar më lartë dhe për këtë arsye është vazhdimësia e pagesës së ambjentit.

***Shpenzime për pritje përcjellje,*** janë parashikuar **0.25 *milionë* lekë**.
Këtu përfshihen detyrimet që ka drejtoria për pritjen dhe përcjelljen e delegacioneve dhe ekspertëve të huaj që vijnë në bazë tëmarreveshjeve të nënshkruara.DPPI është anëtare e WIPO dhe EPO.DPPI ka marrëveshje bashkëpunimi me EUIPO dhe zyrat homologe të Amerikës, Polonisë, Kinës, Turqisë, Kosovës, Maqedonisë, Hungarisë si dhe me institucione vendase. Gjithashtu është planifikuar lidhja e marrëveshjeve të tjera të këtij lloji për të cilat do të ketë nevojë për organizim të pritjeve dhe përcjelljeve të përfaqësuesve zyrtarë. Bazuar në këto marrëveshje duhet të organizohen takime dhe pritje me përfaqësues të këtyre zyrave.
Kjo vlerë është parashikuar bazuar në shpenzime të mëparshme të këtij lloji.

***Shpenzime për honorare (Bordi i Apelit dhe Keshilli Mbikqyres)***janë parashikuar
***0.8 milionë lekë.***
Llogaritjet për këtëparashikim paraqiten në tabelat e meposhtme, bazuar në Vendimin Nr. 252, datë 9.5.2018 për ”Përcaktimin e Masës dhe të Kritereve për Shpërblimin e Kryetarit, Anëtarëve dhe Sekretarit Teknik të Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI)”. Në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 6 pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të këshillit.

## I Këshilli Mbikqyrës

| Nr | **Emër Mbiemër** | **Pagesa Br/ Mbledhje** | **6 mbledhje/vit** |
|---|---|---|---|
| **1** | Kryetar | 15.000 | 90.000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **2** | Anetar | 10.000 | 60.000 |
| **3** | Anetar | 10.000 | 60.000 |
| **4** | Anetar | 10.000 | 60.000 |
| **5** | Anetar | 10.000 | 60.000 |
| **6** | Sekretar | 3.000 | 18.000 |
| | **Total** | **58.000** | **348.000** |

Kryetar 15.000lekë/mbl *6 mbl = 90,000lekë/vit
Sekretar 3.000lekë/mbl * 6 mbl =18,000lekë/vit
Anëtar 4*10.000lekë/mbl *6mbl = 240,000lekë/vit

**Total 348,000 lekë për 6 mbledhje/vit KM**

**II Bordi i Apelit**

| Nr | **Emër Mbiemër** | **Pagesa Br/Mbledhje** | **6 mbledhje** |
|---|---|---|---|
| 1 | Kryetar | 15.000 | 90.000 |
| 2 | Anetar | 15.000 | 90.000 |
| 3 | Anetar | 15.000 | 90.000 |
| 4 | Anetar | 15.000 | 90.000 |
| 5 | Anetar | 15.000 | 90.000 |
| 6 | Sekretar | 5.000 | 30.000 |
| | **Total** | **80.000** | **480.000** |

Kryetar 15.000lekë/mbl *6 mbl =90,000lekë/vit
Anetar 4x15.000lekë/mbl *6 mbl = 360,000lekë/vit
Sekretar 5.000lekë/mbl *6mbl = 30,000lekë/vit

**Total 480,000 lekë për 6 mbledhje/vit Bordi Apelit**

| **602.9** | **SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE** | **000/lekë** |
|---|---|---|
| **9005** | Shpenzime për honorare Keshilli Mbikqyres | 348lekë |
| **9005** | Shpenzime për honorare Bordi Apelit | 480 lekë |
| | **SHUMA** | **828**lekë |

***Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca,*** janë parashikuar në shumën ***0.1 milionë lekë***. Këtu përfshihen të gjitha shpenzime të kryera nga institucioni, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për pjesmarrje në konferenca, seminare e të tjera të ngjashme brendadhe jashtë vendit.

***Tatim taksa vendore,***janë parashikuar **0.03 *milionë* lekë.**Këtu përfshihen të gjitha shpenzime te kryera nga institucioni, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për pagimin e tatimeve dhe taksave të ndryshme si p.sh.tatim ndërtese, taksë pastrimi e të tjera të kësaj natyre.

***Transferta Organizma Ndërkombetare EPO në zbatim të nenit 39 të Konventës Evropiane të Patentave,*** janë parashikuar **90*milionë* lekë**.

Kjo vlerë vjen në zbatim të nenit 39 të KEP, nga i cili Shqipëria është e detyruar t'i kthejë ZEP detyrimet e të gjitha pagesave vjetore të patentave evropiane që arkëtohen në DPPI. Këto të ardhura rriten çdo vit në bazë të rritjes së aplikimeve për Patenta të huaja në fazën kombëtare.

Parashikimipër detyrimin e shumës është bazuar në detyrimin aktual që ka DPPI për transferta në organizma ndërkombëtare.

**Total shpenzime (shpenzime personeli + shpenzime korrente+ transferime të jashtme)** janë parashikuar në vlerën **116 *milionë* lekë.**

## V.3INVESTIMET E PARASHIKUARA PËR VITIN 2023

Qëllimi i DPPI është të stimulojë zhvillimin ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, të sigurojë një funksionim të përshtatshëm të tregut të brendshëm duke vendosur ekuilibrin e duhur ndërmjet të drejtave të pronarëve të objekteve të Pronësisë Industriale dhe interesave të përdoruesve si dhe të forcojë sistemin e regjistrimit dhe mbrojtjes së PI.

Për të realizuar qëllimin e saj, është hartuar plani i aktiviteteve në Strategjinë Kombëtare të PI 2022-2025.
Në të njëjtën linjë, qëllimi i kësaj strategjie është të forcojë Sistemin e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale në Republikën e Shqipërisë dhe ta bëjë atë të krahasueshme me vendet e Bashkimit Evropian, si një mekanizëm stimulues të zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor në Republikën e Shqipërisë. Ky qëllim arrihet nëpërmjet:

- Ofrimit tënjë sistemi të besueshëm dhe efikastëmbrojtjes së tëdrejtave të Pronësisë Intelektuale;
- Nxitjes, zhvillimit dhe shfrytëzimit ekonomiktë Pronës Intelektuale.

Prioritetet strategjike vijnë si rezultat i detyrimeve që rrjedhin nga:

1) Marrëveshja eStabilizim-Asociimit (MSA);

2) Raportet vjetore tëKomisionit Evropian për Shqipërinë;
3)Marrëveshja TRIPS dhe acquis i BE-së.

Qëllimet strategjike të këtij dokumenti lidhen me pesë objektivat e mëposhtëm:

I. Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e pronësisë intelektuale, në përputhje dhe duke përafruar legjislacionin e Bashkimit Evropian
II. Zhvillimi dhe forcimi i institucioneve, të përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisëintelektuale;
III. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel rajonal apo me gjerë, në funksion të përmirësimit të punës në mbrojtje të të drejtave të pronësisë intelektuale;
IV. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit në lidhje me PI në vend;
V. Identifikimi potencial i treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, si një objekt shumë i rëndësishëm i pronësisë industriale, në zhvillimin ekonomik të vendit.

Bazuar në planin e veprimit të Strategjisë së PI 2022-2025, u hartuan edhe projektet që do të ndërmarrë DPPI në planin e saj të punës për vitin 2023.

→ ***Shpenzime kapitale të trupëzuara dhe të patrupëzuara*** janë parashikuar***109 milionëlekë.***

***I)Nga shuma totale e shpenzime kapitale të* trupëzuara**janë ***0 lekë.***

***II) Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara***parashikuar në shumën***123milionëlekë.***

Shuma është planifikuar për të mbështetur identifikimin dhe nxitjen e regjistrimit të markave të shërbimit si dhe produkteve potenciale për tu mbrojtur si tregues gjeografik.
Nga analiza e ekspertevetëWIPO gjatëhartimittëstrategjisësë PI-së, u vërejtqënumri i markavetështërbimitështënëniveletëulëta. Përkëtëqëllimështë e domosdoshmeidentifikimi i bizneseve me potencialtëmundshëm,përregjistrimin e shërbimeveqëatoofrojnësi markëtregtareaposhërbimi, organizimi i seminarevedheaktivitetevetrajnuesenëlidhje me to dhekonsulencënëhartimin e analizëssë situates dheplanitpërrritjen e numrittëaplikimevepërmarkashërbimi. Implementimi i këtijprojektiështëparashikuarnë StrategjinëKombëtaretë PI-së.

Zbatimiinjëprojekti me qëllimkryerjen e njëanalizeterritorialepërevidentimin e produkteve made in Albania përt'uregjistruarsimarkë. Përkëtëqëllimështë e domosdoshme identifikimiibizneseve me potencialtëmundshëmpërregjistrimin e prdukteve Made in Albania.

1. ***Projekt mbi rritjen e ndërgjegjësimit tek brezat e rinj dhe stafet pedagogjikë të ciklit të ulët dhe të mesëm***, fokusuar në formën e leksioneve të hapura, orëve të bashkëbisedimit, lojrave, videove ku përfshin konceptet kryesore të pronësisë intelektuale, broshura të animuara për fëmijë si dhe shpërndarje të materialeve promocionale të dedikuar për këtëkategori.
   Parashikuar në vlerën ***6milionë lekë***

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022-2025 prioritet dhe fokus të punës së saj ka bashkëpunimin e ngushtë me sistemin e arsimit para-universitar dhe atij universitar.
Pasi eksperiencat botërore kanë treguar se praktika të tilla pune janë shumë të dobishme në edukimin e shoqërisë si dhe ndikojnë ndjeshëm në uljen e falsifikimit të produkteve si dhe të piraterisë në një shtet të caktuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit do të kryejë dhe trajnimin e mësuesve në fushën e pronësisë industriale. Për këtëështë domosdoshmëri implementimi i një projekti - pilot 4 vjeçar duke filluar në vitin 2023 për trajnimin e mësuesve për orët edukative, si një aktivitet më i qëndrueshëm, në lidhje me PI-në. Në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) do të planifikojë trajnime për mësuesit në 12 Drejtoritë Rajonale Arsimore.

Si hap fillestar do të nënshkruihet një marrëveshje bashkëpunimi midis DPPI dhe ASCAP për të vednosur dhe për të përcaktuar modalitetet për organizimin e këtij projekti pilot që do të shtrihet në të gjithat DAR-et dhe ZVA-t e vendit tonë.

Shoqëria në tërësi ka nevojë për një ndërgjegjësim më të madh mbi pronësinë industriale dhe objektet e saj. Edukimi i brezave të rinj nëpërmjet shkollave publike dhe shkollave jo publike, është një element thelbësor në zhvillimin e fushës së pronësisë industriale.

Programet mësimore të shkollave nuk ofrojnë formalisht njohuri të mjaftueshme mbi të drejtat e pronësisë industriale, element ky mjaft i rëndësishëm për një karrierë në industritë krijuese. Për të arritur rezultate konkrete dhe të prekshme kërkohet edukimi i brezave që në bankat e shkollës. Duke u mbështetur në eksperiencën e vendeve europiane përfshirja e pronësisë industriale në kurikulat mësimore, do të ishte një zgjidhje efektive. Qëllimi nuk është vetëm shpërndarja e informacionit por dhe nxitja e krijimtarisë dhe se si brezat e rinj të gjejnë zgjidhje praktike dhe të jenë krijues duke nxitur në këtë mënyrë inovacionin dhe krijimtarinë. Politika të tilla ndiqen sot nga vendet e zhvilluara dhe treguesit dhe shembujt janë mjaft pozitivë. Duke punuar paralelisht me nxënsit por duke

trajnuar dhe mësuesit në shkallë DAR dhe ZVA, kjo kthehet në një indikator më të qëndrueshëm.

Sistemi parauniversitar i Tiranës ka qenë për disa vite i përfshirë në trajnimet e ofruara nga stafi i DPPI-së, në përfundim të së cilave organizohej një konkurs mbi njohuritë e përfituara.

Pronësia intelektuale në Shqipëri është një nga fushat që po i kushtohet një rëndësi e vecantë në mbarë botën e zhvilluar, pasi konsiderhet si avantazh krahasues për ekonominë e një vendi, nxit hapjen e vendeve të reja të punës, ndikon në rritjen e GDP së si dhe zhvillimin ekonomik të vendit por dhe luan rol kyc në ruajtjen e vlerave dhe traditave social kulturore të një vendi të caktuar.
Trajnimi i punonjësve arsimorë është nevojë dhe domosdoshmëri për mësuesit, drejtuesit dhe punonjësit e tjerë arsimorë. Qëllimi i tij është përditësimi i njohurive dhe zhvillimi i kompetencave profesionale, që punonjësit t'u sigurojnë nxënësve arsim cilësor. Procesi realizohet duke shfrytëzuar periudhat e vitit që nuk zhvillohet mësim.

Sipas legjislacionit në fuqi, format e trajnimit të mësuesve janë trajnimi në shkolla, rrjetet profesionale, këshillimet, kurset afatshkurtra dhe ato afatgjata. Në legjislacion theksohet se mësuesit dhe drejtuesit trajnohen të paktën 3 ditë në vit dhe se trajnimet zhvillohen sipas sistemit "kërkesë - ofertë", në bazë të kërkesave nga institucionet arsimore dhe të ofertave nga agjencitë trajnuese që mund të jenë publike ose private.

***Afati kohor – Projekti do të shtrihet nga muaji prill deri në muajin nëntor 2023***

**<u>Aktivitetet:</u>**

1. Përsa më lart është menduar ***që trajnimet e mësuesve të bëhen në shkallë Zyre Vendore Arsimore dhe të trajnohen mësuesit e cilkit të arsimit para-universitar,*** kur është e nevojshme dhe me ekspertë të huaj. Trajnimet do të jetë 2-ditor për të përfshirë një cikël të mirë trajnimesh në fushën e pronësisë intelektuale si një lëndë shumë e rëndësishme dhe për vetë mësuesit.

2. Të gjitha trajnimet e mësuesve, rekomandim ky dhe i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) do të bëhet i koordinuar nga ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para-universitar) e cila do të na asistojë në të gjithë projektin.

3. Për të gjithë mësuesit do të ofrohen botime në fushën e pronësisë industriale të përkthyera në gjuhën shqipe, botime të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.

4. Në funksion të këtij projekti do të jetë dhe Website i krijuar nga projekti Twinning për forcimin e të drejtave të pronësisë intelektule ne RSH, një website dedikuar tërësisht pronësisë intelektuale për nxënësit, mësuesit dhe prindërit. Website përmban lojra, kuice, inofmracion mbi të drejtat e pronësisë intelektuale, pyetje përgjigjet, broshura informative etj.

5. Në çdo ZVA pas përfundimit të trajnimit të mësuesve do të organizohet një orë e hapur leksioni për nxënësit e arsimit para-universitar.

6. DPPI dhe ASCAP do të hartojnë një kalendar aktivitetesh për fillimin e këtij projekti i cili do të miratohet dhe dakortësohet nga të dy palët.

7. Në përfundim të vitit të parë të projektit DPPI do të organizojë një konkurs kombëtar duke përfshirë në shkallë vendit nxënësit me njohuritë e fituara nga pronësia intelektuale (testim me shkrim). Më pas nxënësit do të pajisen me certifikatë pjesëmarrjeje dhe për tre vendet e para do të ketë dhe cmime simbolike.

(8 trajnime në vit/ punonjës për çdo trajnim/ DAR dhe ZVA dhe Shpenzime për Qera Salle + pushim kafe+ materiale promocionale+certifikata për cdo mësues të trajnuar+baza materiale logjistike të nevojshme për kryejen e trajnimeve etj).

***2.*** **Ndërlidhja e web nga projektiTwinning me faqen zyrtare të DPPI-së dhe kosto mirëmbajtje.**

Duke qënë se lënda e Pronësisë Intelektuale nuk është e përfshirë në kurikulën mësimore të arsimit para-universitar, është parë e domosdoshme dhe është kërkuar nga projekti krijimi i një faqeje të dedikuar për nxënësit dhe mësuesit për tu aksesuar nga të gjithë kjo grupmoshë në të gjitha qytetet e RSH.

Faqja është krijuar nga Projekti por që mirëmbajtja dhe përditësimi me informacion në këtë fushë do të administrohet nga DPPI, gjithashtu duhet bërë ndërlidhja e web nga projekti Twinning me faqen zyrtare të DPPI-së. Totali për kryerjen e kërij shërbimi do të jetë **1.2*milionë*lekë.**

3. ***Kosto mirëmbajtje për programet e ndryshme kompjuterike*** të parashikuar në vlerën **0.132*milionëlekë***.

Programet kompjuterike të cilat janë si payroll, program i buxhetit, financa 5, etj herë pas here është e domosdoshme përditësimi dhe mirëmbajtja e tyre pasi nga volumi i punës ndodh që mund të ngadalësohen, fiken, ndryshon ndonjë opsion, mund të shtohen opsione, dritare të tjera përveç atyre aktualeve, etj.

4. ***Projekti"Për përmirësimi i sistemit të menaxhimit të informacionit për drejtorinë e përgjithshme të pronësisë industriale (DPPI)" është parashikuar në shumën 107milionë lekë. Ky projekt do të realizohet nga AKSHI.***

Në zbatim te Urdhrit te Kryeministrit Nr. 153 date 25.11.2019 "*Per marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore per aplikimin e sherbimeve vetem on-line nga data 1.1.2020*". Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) që nga Qershori i ketij viti ofron online në portalin qeveritar e-Albania shërbimet për objektet e Pronësisë Industriale.

Në varësi të shërbimit për të cilin aplikohet, ndryshon formulari i aplikimit dhe gjithashtu floë që ky aplikim ndjek në Institucion per procesim.I gjithë ky proces, pas dërgimit të aplikimit online, nuk menaxhohet nga sistemi që DPPI ka aktualisht në administrim.

DPPI ofron online aplikimet per te gjitha shërbimet qe ajo ofron, për të cilat menaxhimi deri ne kete faze ka rezultuar i vështirë në kushtet e mungesës së një sistemi të përshtatshëm backend per trajtimin e tyre dhe punes se shumte manuale per punonjesit e ketij institucioni qe trajtojne keto aplikime

Për këtë qëllim rezulton i nevojshempërmirësimi i një sistemi per menaxhimin e informacionit dhe digjitalizimin procesimit te aplikimeve te shërbimeve qe ofrohen online nepermjet portalit e-Albania nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

***Objektivi që synohet të arrihet:***
Objektivi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i sistemit te menaxhimit te informacionit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin e veprimeve që nga marrja e aplikimit deri të regjistrimi, ndryshimet pas regjistrimit, rinovimet, pensionin, botimet etj. Për më tepër, sistemi do të mundësojë dhe gjurmimin e regjistrimit/aplikimit në të gjitha fazat e përpunimit te tij ne kohe reale.

***<u>Qëllimi</u>***

Sistemi ka për qëllim automatizimin e procesit të ruajtjes, procesimit, regjistrimit, rinovimit, ndryshimit të Markës Tregtare, Patentës dhe Disenjos Industrial. Nëpërmjet këtij sistemi të regjistrit elektronik synohet të arrihen:

1. Përpunimi i aplikimeve për shërbimet që vijnë nga portali e-Albania nga stafi përgjegjës i DPPI, dhe kthimi i përgjigjes përmes sistemit backend te qytetarët/subjektet që kanë kryer aplikimin.
2. Zvogëlimi i kohës së ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset. Çdo komunikim dhe ndërveprim me qytetarët.
3. bizneset do të kryhet elektronikisht pa patur nevoje per prezence fizike.
4. Përdorim eficient i informacionit të qendërzuar dhe ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje bazuar në analiza të detajuara.

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore", në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencalitetin e sistemit.

Vlera e projektit të AKSHIT mbështetet dhe në shkresën Nr. 3129 prot., datë 26.05.2022, administruar në DPPI me Nr. 489 prot., datë 30.05.2022, në të cilën është shprehur vlera e implementimit të projektit për vitin 2023. Vlera totale e projektit të AKSHIT është e përbërë nga vlera e trashëguar e vitit 2022 ku përfshihet edhevlera e alokuar nga "Shpenzime personeli ne "Shpenzime kapitale" sipas V.K.M Nr. 886, date 27.12.2022 "*Për një ndryshim në Vendimin nr. 34, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2022*", vlera e parashikuar për vitin 2023 si dhe nga tepricat e investimeve të vitit 2022.

5. ***Projekti"Mbi studimin, identifikim dhe nxitjen e rregjistrimit te Treguesve Gjeografik" është parashikuar në shumën 3 milionë lekë.***

Objektivi kryesor është një s*istem më i fortë i Pronësisë Intelektuale në Republikën e Shqipërisë, i cili siguron një mbrojtje efektive të objekteve të PI, inkurajon krijimtarinë dhe inovacionin në funksion të stimulimit tërritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë.*

**1.2 Objektivi specifik:**

Konsiston në studimin, identifikimin dhe nxitjen e regjistrimit të treguesëve gjeografik, në përputhje me zërat e parashikuara në buxhetin e DPPI për vitin 2022 duke përmbushur në këtë mënyrë objektivat dhe prioritetet e DPPI-së.

Në mjedisin e sotëm të konkurrencës ekonomike (globalizim), objektet e pronësisë industriale, (patentat, markat tregtare, disenjot industriale, tregusit gjeografik, kontratat e liçensimit etj) po bëhen gjithnjë dhe më e rëndësishme në vendin tonë.

Në nivel kombëtar, pronësia intelektuale sot përbën një faktor të rëndësishëm ekonomik, duke kontribuar dhe duke luajtur rolin e saj në krijimin e pasurisë së paprekshme.

Ky Projekt do të kontribuojë drejtpërsëdrejti në objektivat e përmendura në dokumentet e mëposhtme strategjike dhe / ose programore:

*Plani Kombëtar për Integrimin Evropian*2023-2025është dokumenti ligjor kombëtar që rregullon përafrimin e legjislacionit shqiptar me ate të Bashkimit Evropian. Një nga objektivat specifikë brenda këtij Plani është mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale: zhvillimi dhe zbatimi i strategjive dhe politikave në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale; përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit në dobi të autorëve dhe krijuesve të tjerë, krijimtarisë artistike dhe kulturore dhe trashëgimisë kulturore; përmirësimi i kornizës ligjore për pronësinë intelektuale për të promovuar transferimin e njohurive dhe teknologjisë.

DPPI ka bërë përparim në fushën e pronësisë industriale, duke harmonizuar legjislacionin me direktivat e BE-së në këtë fushë. Mjetet janë përdorur për të rritur kulturën e të drejtave të pronësisë industriale, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve në të drejtat dhe parimet e pronësisë industriale. DPPI ka vijuar procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* të Unionit, duke synuar një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për pronësinë industriale, proces që do të pasojë edhe në të ardhmen.

Sipas Raportit të Progresit të BE-së të nxjerrë në vitin 2021-2022, Shqipëria ka bërë përparim në harmonizimin me *acquis communautaire* në fushën e pronësisë intelektuale.

Korniza ligjore e Republikës së Shqipërisë siguron mbrojtjen e pronës industriale që përafrohet gjerësisht me *acquis communautaire,* duke plotësuar një nga angazhimet e nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Kapitullin 7 "Të drejtat e pronësisë intelektuale", si dhe të Planit Kombëtar për Integrimin Europian 2022-2024.

Dokumenti i Partneritetit Evropian thekson nevojën për të vazhduar forcimin e autoriteteve relevante të Tregut të Brendshëm, duke përafruar plotësisht legjislacionin e brendshëm me acquis të Unionit dhe kërkesat e MSA-së dhe të sigurojë zbatimin e tij nga të gjitha autoritetet relevante. Në mënyrë eksplicite përmend nevojën për të garantuar kapacitete të mjaftueshme administrative për të përmbushur kërkesat e MSA-së në fushën e pronësisë intelektuale dhe industriale.

Në këtë drejtim, neni 39 i Marrëveshjes së Përkohshme (neni 73 i MSA) përcakton që Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar, jo më vonë se katër vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, një nivel mbrojtjeje intelektuale, industriale dhe tregtare, të ngjashme me ato që ekzistojnë në BE, duke përfshirë mjetet efektive për zbatimin e këtyre të drejtave.

Është raportuar se ekonomia e Republikës së Shqipërisë bazohet në sektorët e shërbimit (54.1%), bujqësisë (21.7%) dhe industrisë (24.2%). Vendi ynë ka disa burime natyrore. Ekonomia mbështetet kryesisht nga bujqësia, përpunimi i ushqimit, lënda drusore, nafta, çimentoja, kimikatet, minierat, metalet bazë, hidrocentralet, turizmi, industria e tekstilit dhe nxjerrja e naftës. Sektorët më të fortë janë energjia, minierat, metalurgjia, bujqësia dhe turizmi. Eksportet kryesore industriale janë veshja dhe kromi. Këto janë fushat ku është e nevojshme për të kërkuar fillimin dhe pastaj zhvillimin e sektorëve të tjerë.

Në kuadër të aktiviteteve promovuese që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale kryen në këtë fushë, si dhe në përmbushje të të gjitha objektivave institucionale me qëllim rritjen e aplikimeve për regjistrimin dhe promovimin e objekteve të pronësisë industriale, sugjerojmë që dhe në kuadër të Ditës Botërorë të Pronësisë Intelektuale, DPPI të ndërmarë aktivitete të ndryshme me qëllim promovimin dhe informimin e bizneseve me produketet “Made in Albania” si dhe promovimin e një tjetër objekti të rëndësishëm të pronësisë industriale, atë tëtreguesëve gjeografikë.

Sot, pronësia intelektuale në Shqipëri është një nga fushat që po i kushtohet një rëndësi e veçantë në mbarë botën e zhvilluar, pasi konsiderohet çelësi për një ekonomi të qëndrueshme, nxit hapjen e vendeve të reja të punës, ndikon  në rritjen e GDP së vendit por dhe luan rol kyç në ruajtjen e vlerave dhe traditave social-kulturore të një vendi të caktuar.

## 1. SITUATA AKTUALE E PRONËSISË INDUSTRIALE

Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale përcaktohet dhe rregullohet me anë të Ligjit Nr. 9947, dt 07.07.2008, ‘’Për Pronësinë Industriale’’, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatimin të tij. Ndryshimet ligjore ishin përmbushje e detyrave të lëna në raportet e Komisionit Evropian, dhe pasqyrim i angazhimeve dhe

synimeve të qeverisë shqiptare, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e cilësisë së shërbimeve, rregullime dhe saktësime të problemeve të hasura nga zbatimi i ligjit të mëparshëm në praktikë, si dhe përshtatja me eksperiencat dhe praktikat më të mira të zyrave homologe ndërkombëtare.

Theksojmë se, shërbimet e DPPI-së po shkojnë drejt standardeve bashkëkohore për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian, ashtu siç është e përcaktuar qartë në Marrëveshjen e AsociimStabilizimit (neni 73 i saj). Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, kuadri ligjor përfshin së pari, Ligji Nr. 9947 "Për pronësinë industriale", (i ndryshuar). Ky Ligj është plotësisht i përafruar me acquis e mëposhtme të BE-së:

- Direktiva 98/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 korrikut 1998 mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike;
- Direktiva 98/71/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor 1998 mbi mbrojtjen ligjore të disenjove;
- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 6/2002 e datës 12 dhjetor 2001 mbi disenjot e Komunitetit;
- Direktiva 87/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 Dhjetor 1986 mbi mbrojtjen ligjore të topografive dhe produkteve gjysmëpërçues;
- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- Direktiva 2015/2436/EC, dt. 16.12.2015 "Për harmonizimin e bazës ligjore të vendeve anëtare në lidhje me markat tregtare";
- Rregullorja Nr. 1151/2012/EC të datës. 21.11.2012 "Për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore";
- Rregullorja Nr. (EEC) Nr. 1308/2013/EC dt. 17.12.2013 "Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe shfuqizimin e rregulloreve (EEC) Nr. 922/72, (EEC) Nr. 234/79, (EC) Nr. 1037/2001 dhe (EC) Nr. 1234/2007".
- Direktiva 2004/48/EC mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale
- Direktiva 2016/943 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 maj 2016 mbi mbrojtjen e njohurive dhe informacioneve të biznesit kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të tyre të paligjshëm (sekreti tregtar).

## 1.1 Kuadri institucional

Gjatë vitit 2018 në DPPI është kryer reforma e thellë institucionale, e cila konsistoi në miratimin e strukturës së re me 39 punonjës, një shtesë personeli prej 15 punonjësish të

rinj. Plotësimi hap pas hapi i të gjithë vendeve vakante në strukturë, ka sjellë dhe do të ketë një impakt pozitiv për të kryer një shërbim cilësor, profesional dhe të njejtë me zyrat tona homologe jashtë vendit. Numri i lartë i aplikimeve për objektet e pronësisë industriale ka sjellë rritje të të ardhurave të DPPI-së. Gjithashtu, është rritur dhe cilësia e shërbimeve në këtë fushë, kjo falë punës intesive të kryer.

Organet drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm**.**

Kompetenca e DPPI ushtrohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

Drejtori i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e kësaj drejtorie dhe ndjek përmbushjen e dispozitave të parashikuara në këtë ligj dhe rregulloret e nxjerra në zbatim të tij.

Qendra e trajnimeve e PI, e cila është pjesë e strukturës dhe organizimit të DPPI, organizon aktivitete, kurse, trajnime dhe seminare në fushën e PI.

ARRITJE

Edhe pse Shqipëria nuk është ende pjesë e Familjes së madhe Evropiane, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale vijon me përafrimin jo vetëm të legjislacionit por edhe të praktikave të BE.

-LIGJI NR. 90/2018 PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E LISBONËS PËR MBROJTJEN E EMËRTIMEVE TË ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN E TYRE NDËRKOMBËTAR

-VENDIMNR. 251, DATË 24.4.2019 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR TREGUESIT GJEOGRAFIKË DHEEMËRTIMET E ORIGJINËS.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në rolin  Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës, ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr.118, datë 23.9.2020, si dhe me mbështjetjen e institucioneve të përfshira në këtë proces, ka propozuar hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të PI-së. Ky dokument është hartuar me kontributin e anëtarëve të grupit ndërinstitucional të punës të ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr.118, datë 23.09.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të dokumentit strategjik për Pronësinë Intelektuale2021-2025” si dhe me asistencën teknike të ofruar nga ekspertët e Organizatës Botërore për Pronësinë Intelektuale (OBPI) si një nga partnerët tanë më të rëndësisëshëm në rrugëtimin e institucioneve për një sistem të qëndrueshëm të pronësisë intelektuale. Raporti i përgatitur nga ekspertët e delegacionit të OBPI-s u hartua mbështetur në

analizën e bazës së të dhënave të DPPI, në intervistat e organizuara me institucionet e përfshira në sistem, në pyetësorët e plotësuar nga institucionet si dhe me grupet e interesit. Një kontribut të vyer në lidhje me treguesit gjeografik, ka dhënë dhe Projekti shqiptaro-zvicerian në fushën e pronësisë intelektuale i cili me ndihën e ekspertëve të kontraktuar ndërkombëtare dhe vendas ka hartuar raportin në lidhje me "Vlerësimin e sistemit të Treguesve Gjeografikë në Republikën e Shqipërisë"Kjo strategji është detyrim i parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021 -2023, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Qëllimi i kësaj Strategjie është të stimulojë zhvillimin ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend, të sigurojë një funksionim të duhur të tregut të brendshëm duke vendosur ekuilibrin e duhur midis interesave të pronarëve të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe interesave të përdoruesve, dhe forcimi i sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së pronës intelektuale.
Ky qëllim strategjik duhet të arrihet duke siguruar mbrojtje të besueshme dhe efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe duke inkurajuar, zhvilluar dhe shfrytëzuar ekonomikisht pronën intelektuale.Në mënyrë specifike do të mund të shërbejë si një mjet i politikës për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe garanton suksesin në treg.

Një nga objektivat kryesore të kësaj strategjie është identifikimi dhe promovimi i treguesve gjeografikë. Një mbeshtetje në këtë drejtim do të japë dhe projekti ALSIP ne fushën e pronësisë intelektuale në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit-Rural.

TE DHENA STATISTIKORE PËR VITIN 2022

1. APLIKIME PËR REGJISTRIMTETREGUESVE GJEOGRAFIKE/Emërtime Origjine

Ndër vite, pranë DPPI janë paraqitur për regjistrim 24 aplikime për Tregues Gjeografik / Emërtim Origjine, nga të cilat 17 janë regjistruar. Në vitin 2021 është depozituar 1 emërtim origjine nga një shoqëri shqiptare, siç janë paraqitur edhe në grafikun e mëposhtëm:




1.2 Aktivitetet e planifikuara në kuadër të këtij projekti

Një nga objektet e pronësisë Industriale dhe që kërkon një vëmendje të veçanta për tu promovuar dhe për tu bërë i njohur për grupet e interesit është treguesi gjeografik, i cila është shumë i rëndësishëm dhe ndikon në zhvillimin ekonomik si të subjekteve të interesuara si dhe vendit tonë gjithashtu.

Gjithashtu ky projekt vjen dhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë së re Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022-2025, ku një vemendje e veçantë do ti kushtohet treguesëve gjeografikë.

Aktivitetet që mendohet të organizohen janë të ndryshme dhe të larmishme që nga takime me dhomat e tregtisë në rrethe të ndryshme të vendit, materiale promocionale, panaire të ndryshme në zona të caktuara të Shqipërisë, ngritja e stendave dhe prodhimi i materialeve informuese dhe promovuese me fokus të drejtat e pronësisë industriale, organizimi i një aktiviteti përmbyllës në Tiranë dhe gjetja e rezultateve të projektit. Mbrojtja e këtyreprodukteveunikeShqiptareparaqetrëndësitëveçantëpërvendintonëpasiregjistrimikombëtar e mëtejaindërkombëtarndikonnërritjen e vlerës, gjallërimin e zonaverurale, ruajtjen e biodiveristetitdheofronmundësinë e njohjesnëtregjet e huaja.

Duke parë përfitimet që vinë nëpërmjet rregjistrimit të treguesëve gjeografikëdhe rolin e tyre në përmirësimin e zhvillimit të mjedisit ekonomik në vend, DPPI ka planifikuar disa aktivitete ne kuadër të këtij projekti.

1. Identifikimi i bizneseve me potencial të mundshem për tregues gjeografikësi dhe organizimi i seminareve dhe aktiviteteve trajnuese në lidhje me to dhe zhvillimi i takimeve pranë bizneseve në qarqe të ndryshme të vendit.

i. Organizimi i aktiviteteve promovuese tek bizneset me potencial prodhues dhe jo vetëm, duke zhvilluar takime ballë për ballë në ambjentet e vetë biznesit duke qënë më pranë tyre duke ofruar asistencë si dhe duke zhvilluar promovim në rritjen e ndërgjegjësimit mbi treguesit gjeografikë. Këto takime do të zhvillohen jo vetëm në qytetin e Tiranës por edhe në qarqe të ndryshme të vendit ku mund të përmëndim si: qytetin e Shkodrës, Lezhës, Kukësit, Durrësit, Fierit, Gjirkostrës, Sarandësme mbështetjen dhe të Dhomave lokale të Tregtisëetj.
Këto takime janë ndërrmarrëedhe në vitet e kaluara ku DPPI ka qënë prezente me tre përfaqësues të saj dhe kanë rezultuar me sukses në rritjen e numrit tëtreguesëve gjeografikë si dhe të objekteve të tjera të PI-së, duke pasur parasysh burimet financiare të kufizuara dhe rolin thelbësor që DPPI ka në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e një mbrojtjeje efektive të pronësisë industriale dhe ndikimin e saj në zhvillimin social kërkon mbështjeje me anë të këtij projekti në realizimin e synimeve të saj .
ii. Gjithashtu, në vendet që evidentohen me numër të vogël biznesesh do të organizohen në formën e një seminari ose aktivitet trajnues.
iii. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve dhe shpërndarja e materialeve promocionale në qarqet kryesore te vendit në bashkëpunim dhe me Dhomat Lokale të Tregtisë dhe Industrisë dhe konkretisht: Shkoder, Lezhë, Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Korçë, etj.
iv. Përgatitja dhe printimi/shumëfishimi i materialeve promocionale me qëllim dhëniene informacionit për bizneset dhe kompanitë që operojnë në treg.
v. Ngritja e stendave me materiale promocionale.
vi. Organizimi i dy panaireve në zona agroturistike nëFishtë-Kallmet, Gjirokastër dhe në zonën e Peshkopi-Dibër, si dhe në qytetin e Pogradecit dhe rrethina të tij.
vii. Ngritja e një stende në qendër të qytetit me orare të caktuara gjatë ditës, ku do të shpërndahen informacione të ndryshme dhe broshura në lidhje me objektet e pronësisë industriale dhe rëndësine e rregjistrimit të tyre pranë DPPI-së;
viii. Studim mbi gjetjet pas përfundimit të projektit.

Gjithashtu, përditësimi i faqes zyrtare të DPPI (www.dppi.gov.al) dhe rrjetet sociale me informacione të rëndësishme do të jetë në mënyrë të vazhdueshme.
*Realizimi i këtij projekti do na ndihmojënë disa drejtime si:*

i. Kryerjen e Analizës duke studiuar tregun për bizneset potenciale për mbrojtjen e pronësisë industriale, kryesisht për treguesit gjeografikë.

ii. Evidentimin e produkteve potencialesi disenjo industriale dhe produktet të mirënjohura "Made in Albania" si dhe markat e shërbimit;
iii. Organizimi i aktiviteteve promovuese për identifikimin, mbrojtjen dhe regjistrim të objekteve të pronësisë industriale i organizuar nëpër rrethe të ndryshme të vendit.
iv. Analiza do të jetë baza për evidentimin e rendësisë për aktivitete ndërgjegjësimi në rrethe të tjera të Republikës së Shqipërisë.
v. Përgatitja dhe printimi/shumëfishimi i materialeve promocionale me qëllim dhëniene informacionit për bizneset dhe kompanitë që operojnë në treg.

**/000 lekë**

| Nr. | Përshkrim | Sasi | Çmim/Njësi | TOTALI/LEKË |
|---|---|---|---|---|
| **1.** | Panaire | 4 | 190 | 760 |
| **2.** | Drekë | 50 | 6 | 300 |
| **3.** | Tranport me autobus (vajtje-ardhje) | 10 | 40 | 400 |
| **4.** | Logjistikë (materialet promovuese, mikrofon, laptop, videoprojektor,fonia, etj) | 4 mikrofona, 1 videoprojektor, 1 laptop. | 50 | 200 |
| **5.** | Ambient me qira | 4 | 35 | 140 |
| **6.** | Stenda | 5 | 40 | 200 |
| **7.** | Konferencë përmbyllëse për promovimin e TGJ | 1 | 1.000 | 1.000 |
| **Totali në Lekë** | | | | **3.000** |

**6.** Projekti ***"30 Vjetori i DPPI" është parashikuar në shumën 6 milionë lekë.***

Organizimi i një ceremonie zyrtare me rastin e krijimit të 30 vjetorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

KRIJIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Vizioni i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në lidhje me sistemin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale (PI), është që të mundësojë forcimin e pronës intelektuale në të gjithë territorin e vendit dhe të sigurojë një mbrojtje efektive të objekteve të PI-së.Gjithashtu, të inkurajojë kreativitetin dhe inovacionin në shërbim të zhvillimit të rritjes ekonomike, kulturore dhe shkencore në Republikën e Shqipërisë. Në

vitin 1957 ka ekzistuar Zyra për regjistrimin e Markave Tregtare, e cila ka funksionuar pranë Dhomës së Tregtisë së Shqipërisë dhe në 22 mars të vitit 1993, u krijua me V.K.M Nr.135, zyra për funksionimin e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale. Kjo zyrë ka funksionuar si baza për forcimin e sistemit të PI-së si dhe për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale për këto objekte: Shpikjet dhe Modelet e Përdorimit, Markat Tregtare dhe të Shërbimit, Disenjot Industriale dhe Emërtimet e Origjinës.
Kjo zyre u rikonceptua si Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) e cila aktualisht funksionon si një institucion publik jo-buxhetor në formën e një agjencie autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, me seli në Tiranë. Veprimtaria e DPPI përcaktohet dhe rregullohet me anë të Ligjit Nr. 9947, dt 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale’’, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatimin të tij dhe VKM miratuar me VKM nr. 350, datë 26.5.2022 "Për Miratimin e Stategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025".
Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale përcaktohet dhe rregullohet me anë të Ligjit Nr. 9947, dt 07.07.2008, ‘’Për Pronësinë Industriale’’, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatimin të tij. Ndryshimet ligjore ishin përmbushje e detyrave të lëna në raportet e Komisionit Evropian, dhe pasqyrim i angazhimeve dhe synimeve të qeverisë shqiptare, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e cilësisë së shërbimeve, rregullime dhe saktësime të problemeve të hasura nga zbatimi i ligjit të mëparshëm në praktikë, si dhe përshtatja me eksperiencat dhe praktikat më të mira të zyrave homologe ndërkombëtare.
Theksojmë se, shërbimet e DPPI-së po shkojnë drejt standardeve bashkëkohore për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian, ashtu siç është e përcaktuar qartë në Marrëveshjen e AsociimStabilizimit (neni 73 i saj). Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, kuadri ligjor përfshin së pari, Ligji Nr. 9947 “Për pronësinë industriale”, (i ndryshuar). Ky Ligj është plotësisht i përafruar me acquis e mëposhtme të BE-së:

- Direktiva 98/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 korrikut 1998 mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike;
- Direktiva 98/71/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor 1998 mbi mbrojtjen ligjore të disenjove;
- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 6/2002 e datës 12 dhjetor 2001 mbi disenjot e Komunitetit;
- Direktiva 87/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 Dhjetor 1986 mbi mbrojtjen ligjore të topografive dhe produkteve gjysmëpërçues;
- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- Direktiva 2015/2436/EC, dt. 16.12.2015 “Për harmonizimin e bazës ligjore të vendeve anëtare në lidhje me markat tregtare”;

• Rregullorja Nr. 1151/2012/EC të datës. 21.11.2012 “Për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”;
• Rregullorja Nr. (EEC) Nr. 1308/2013/EC dt. 17.12.2013 “Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe shfuqizimin e rregulloreve (EEC) Nr. 922/72, (EEC) Nr. 234/79, (EC) Nr. 1037/2001 dhe (EC) Nr. 1234/2007”.
• Direktiva 2004/48/EC mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale
• Direktiva 2016/943 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 maj 2016 mbi mbrojtjen e njohurive dhe informacioneve të biznesit kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të tyre të paligjshëm (sekreti tregtar).

Ky akt ligjor u ndryshua së fundmi me Ligjin Nr. 96/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, për të përafruar më tej në legjislacionin shqiptar Direktivën 2016/943 për mbrojtjen e sekreteve tregtare, krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Pronësisë Industriale, Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale (SAPI) si dhe disa ndryshime mbi rregullimin e parimeve të përgjithshme të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) në fushën e PI.

Që prej datës 7.7.2021, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi ligji 96/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9947/2008 Për Pronësinë Industriale”, që konsiston në përafrimin e direktivës së Sekretit Tregtar, krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Pronësisë Industriale, Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale (SAPI) si dhe disa ndryshime që janë kërkuar nga ana e ISHMT mbi rregullimin e parimeve të përgjithshme të funksionimit të saj në fushën e PI.

2.1 Kuadri institucional

Gjatë vitit 2018 në DPPI është kryer reforma e thellë institucionale, e cila konsistoi në miratimin e strukturës së re me 39 punonjës, një shtesë personeli prej 15 punonjësish të rinj. Plotësimi hap pas hapi i të gjithë vendeve vakante në strukturë, ka sjellë dhe do të ketë një impakt pozitiv për të kryer një shërbim cilësor, profesional dhe të njejtë me zyrat tona homologe jashtë vendit. Numri i lartë i aplikimeve për objektet e pronësisë industriale ka sjellë rritje të të ardhurave të DPPI-së. Gjithashtu, është rritur dhe cilësia e shërbimeve në këtë fushë, kjo falë punës intesive të kryer

Organet drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Kompetenca e DPPI ushtrohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

Drejtori i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e kësaj drejtorie dhe ndjek përmbushjen e dispozitave të parashikuara në këtë ligj dhe rregulloret e nxjerra në zbatim të tij.

Qendra e trajnimeve të PI-së, e cila është pjesë e strukturës dhe organizimit të DPPI, organizon aktivitete, kurse, trajnime dhe seminare në fushën e IP.

HISTORIKU I ZYRËS

Historikisht Shqipëria ka pasur ligje për markat tregtare që nga fillimi i shekullit. XX. Bazuar në dokumentet arkivore, marka e parë tregtare daton në 16 prill të vitit 1920, lëshuar për “HOBDARI”. Kjo markë u përdor për produktet e kompanisë “Hobdari” që nga fillimi i vitit 1914 e cila krijoi fabrikën e sapunit. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë mbrojtur një numër i madh markash të huaja në Shqipëri si: SIMANCO, SINGER, KAFFE HAG, RETTUNGSRING, etj.

Sistemi i regjistrimit të markës tregtare ishte në fuqi deri në vitin 1944, kur u instalua regjimi komunist në Shqipëri.Në vitin 1957, qeveria e asaj kohe, me vendimin e vet, njohu regjistrimin e markave të huaja në Shqipëri.

Me ndryshimin e regjimit, më 22 mars 1993 është marrë vendimi për themelimin e Zyrës së Patentave për Shpikje, me propozim të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë. Këtë vit DPPI feston 30 vite nga krijimi i saj dhe është menduar që të organizohet një aktivitet në formën e një ceremonie.

QËLLIMI I AKTVITETIT:

DPPI, propozon që me rastin e këtij 30 vjetori, Republika e Shqipërisë do të presë 3 krerët më të lartë të organizatave ku Shqipëria aderon, si EPO, WIPO, EUIPO (ende nuk është shtet anëtar, por ka rolin e vëzhguesit) duke organizuar një ceremoni zyrtare. Në këtë ceremoni është menduar të ftohen përfaqësues nga qeveria shqiptare, përfaqësues nga organizma të huaj diplomatike në Shqipëri, përfaqësues nga bizneset, institucionet kërkimore, universitetet dhe përfaqësues të autorizuar, si dhe përfaqësues nga vendet e CEBS dhe zyrat homologe, me të cilat DPPI, ka të nënshkruara memorandum bashkëpunimi, sa më poshtë:

- Zyra Kineze,
- Zyra Austriake,
- Polake,
- Kosovare,
- Maqedonia e Veriut,
- Turke,
- Amerikane,
- Hungari
- Çeki
- Serbi.

Zhvillimi i aktiviteteve të ngjashme, është praktikë e shumë zyrave homologe të vendeve të tjera, të cilat ftojnë pjesëmarrës nga organizatat ndërkombëtare të PI-së dhe vendeve të tjera.

Fokusi kryesor në zbatimin e aktiviteteve që rrjedhin nga “Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022-2025”, është përmirësimi i funksionit të sistemit të pronësisë intelektuale, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e inovacionit, përmes inkurajimit të punës kërkimore, veçanërisht nga kompanitë shqiptare, universitetet dhe personat fizikë.

MËNYRA E ORGANIZIMIT

Dy ditë konferencë ndërkombëtare me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë “The importance of IP” (TBC)

- Sallë konferencash me kapacitet prej 150 personash (TBC) me gjithë logjistikën e nevojshme për organizimin e eventit 2 ditor (badge, dosje, stilolapsa, canta kartoni, etj)
- Salla do të pajiset me materiale promocionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale si: 1 banner, poster, 4 roll-up, fletëpalosje, agjendat dhe dokumentacioni I nevojshëm I printuar, blerja e dhuratave për të pranishmit dhe për 3 krerët e institucioneve të larta,
- Regjistrimi i të ftuarve (ora 9-9:30)
- Aktiviteti është menduar të zhvillohet në formën e një ceremonie ku do të mbahen fjalime përshëndetëse në podium nga personalitete të ndryshme, Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së, gjithashtu edhe fjalë të tjera përshëndetëse nga shpikësit, biznese të mirënjohura, përfaqësues të autorizuar, profesorë, dhe përfaqësues të zyrave homologe, etj
- Gjatë ceremonisë do të nënshkruhen marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet DPPI-së dhe zyrave homologe në një tavolinë të veçantë pranë podiumit me dy vende, për drejtuesit që do të nënshkruajnë këto marrëveshje (TBC).

EVENTI I DARKËS

- Darka do të organizohet në formën ku do të shërbehen pije dhe ushqime të ndryshme, nga kulinaria shqiptare (Mrizi i Zanave).
- Prezent do te jetë një artist/e cili do të performojë muzikë të lehtë instrumentale (si blues, jazz, rock’n roll, etj) duke përfshirë shtetet e ndryshme pjesëmarrëse në event.
- Një element interesant gjatë ceremonisë do te jetë shfaqja në Led Wall background e një videoklipi me aktivitetet e DPPI-së ndër vite,
- Transmetimi i një dokumentari të shkurtër për 30 vjetorin e krijimit të DPPI-së,
- Në përfundim të ceremonisë, do të ndahet torta e 30 vjetorit të krijimit të DPPI-së, me numrin 30 (ora 22:00-22:30).
- Autobus në dispozicion, i cili do të shoqërojë delegacionet e huaja sipas agjendës.

REZULTATET E PRITSHME TË AKTIVITETIT:

- krijimi i një imazhi pozitiv të zyrës,
- promovimi i rolit dhe funksioneve të saj,
- krijimi i bashkëpunimit sa më të frytshëm me institucionet e tjera,
- Përfaqësimi i Republikës së Shqipërisë, sa më dinjitoz jo vetëm për fushën e PI-së por edhe krijimin e një imazhi për vendin.

INSTITUCIONET PARTNERE DHE GRUPET E INTERESIT:

- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut,
- Universitetet e vendit,
- Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë,
- Prodhuesit Vendor,
- Shoqatat e ndryshme,
- Organizatat Ndërkombëtare të Përfshira në Fushën e PI-së.
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave,
- Ministria e Kulturës/Drejtoria për të Drejtën e Autorit,
- Ministria e Financave dhe e Ekonomisë,
- Ministria e Punëve të Jashtme,
- Ministria e Arsimit dhe Sportit,
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare,
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë,
- Autoriteti i Mediave Audiovizive,
- Shkolla Magjistraturës,
- Ministria e Bujqësisë,
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit,
- Agjencia Kombëtare për kërkim Shkencor dhe Inovacion,
- Agjencia e Sigurimit të Cilësise së Arsimit Parauniversitar,
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Për një promovim sa më efiçent në këtë aktivitet, do të ftohen dhe media të ndryshme dhe do të kryhet transmetimi i një dokumentari të shkurtër, për 30 vjetorin e DPPI-së, në kanalet televizive.

Vlera totale për organizimin e këtij eventi dhe mbulimin e kostove nga ana e DPPI-së, parashikohet të jetë rreth: 6 ***milionë*** lekë.

| NR. | PËRSHKRIMI | SASIA | ÇMIMI/NJESI | TOTALI/LEKE |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Banner/Poster/Roll-up | 10 | 14,160 | 141,600 |
| 2 | Fletëpalosje (historiku zyrës) | 500 | 500 | 250,000 |
| 3 | Badges | 150 | 150 | 22,500 |
| 4 | Dosje, stilolapse, agjenda, çanta, mbajtese kartvizitash, gota me 30 vjetorin logo | 300 | 300 | 90,000 |
| 5 | Prodhim i dokumentarit te shkurter te DPPI-se (20 minuta) | 1 | 2,500,000 | 2,500,000 |
| 6 | Led wall background për skenën (shfaqje e dokumentarit të shkurtër 20' të DPPI-së) | 2 | 150,000 | 300,000 |
| 7 | Prodhim i dy flamujve te medhenj me logo DPPI-se per 30 vjet) | 2 | 15,000 | 30,000 |
| 8 | Qira salle (tavolina, podium, etj) | 2 | 115,150 | 230,300 |
| 9 | Violinistë (ose në mungese te pianistit do te jete nje artist) | 2 | 100,000 | 200,000 |
| 10 | Moderator për hapjen dhe për prezantimin e cermonisë (Z. Blendi Salaj) | 2 | 50,000 | 100,000 |
| 11 | Coffee break | 300 | 2,000 | 600,000 |
| 12 | Tortë për 30 vjetorin e DPPI-së dhe nr. 30 | 100 | 150 | 15,000 |
| 13 | Akomodim per perfaqesuesit e zyrave homologe: Serbi, Kosove, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi (Hotel Tirana International) | 8 | 28,200 | 225,600 |
| 14 | Pajisjet e domosdoshme te perkthimit, si kufje, mikrofon,foni, etj) | 100 | 1,500 | 150,000 |
| 15 | Transport autobus | 80 | 10,000 | 800,000 |
| 16 | Perkthyes (anglisht-shqip-anglisht) | 2 | 60,000 | 120,000 |
| 17 | Pije te ftohta mireseardhjeje (shampanje, uje, kafe) | 150 | 1,500 | 225,000 |
| | **TOTALI NE LEKE** | | | **6,000,000** |

## VI. PËRMBLEDHËSE E KËRKESAVE BUXHETORE 2023

000/ lekë

| | | | 600 | 601 | 602 | 603 | 604 | 605 | 606 | 230 | 231 | 232 | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Grupi** | Titulli | Kapitulli | Pagat | Kontrib. e Sigurimeve Shoqerore | Mallra dhe Sherbime | Subvenci-onet | Te Tjera Transfer. Korrente Brendshme | Transfer. Korrente te Huaja | Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individet | Shpenzime Kapitale te Patrupezu-ara | Shpenzime Kapitale te Trupezuara | Transferta Kapitale | Teprica dedhje ne buxhet | |
| | 1 | Viti 2018 | 45,780.00 | 8,000.00 | 69,958.00 | 0 | 3,000.00 | 13,368.00 | 0 | 49,008.00 | 73,507.00 | 0 | 3,892.00 | 250,145.00 |
| | 2 | Viti 2019 | 39,200.00 | 6,500.00 | 27,750.00 | 0 | 0 | 20,000.00 | 0 | 36,555.00 | 114,185.00 | 0 | 0 | 244,190.00 |
| | 3 | Viti 2020 | 38,000.00 | 7,000.00 | 129,902.00 | 0 | 3,300.00 | 25,000.00 | 0 | 21,755.00 | 57,953.00 | 0 | 0 | 282,910.00 |
| | 4 | Viti 2021 | 42,000.00 | 8,000.00 | 36,120.00 | 0 | 0 | 6,607.00 | 0 | 131,605.00 | 1,980.00 | 0 | 0 | 226,312.00 |
| | 5 | Vitit 2022 | 44,000.00 | 13,000.00 | 34,650.00 | 0 | 0 | 20,000.00 | 0 | 97,300.00 | 2,500.00 | 0 | 0 | 211,450.00 |
| | 6 | Viti 2023 | 41,521.00 | 14,300.00 | 25,716.00 | 0 | 0 | 90,000.00 | 0 | 123,332.00 | 0 | 0 | 0 | 294,869.00 |

**Grupi i punës së hartimit të projektbuxhetit dhe relacionit shpjegues:**

**Afërdita Rokaj**
Drejtor i Drejtorisësë Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

**Përparim Mezini**
Përgjegjës i Sektorit Juridik

**Ina Stefa**
Përgjegjës Sektori i Buxhetit, Financës dhe Burimeve Njerëzore

**Nora Refatllari**
SpecialisteSektori i Buxhetit, Financës dhe Burimeve Njerëzore

**Konceptoi: Nora Refatllari /** SpecialistebuxhetiSektori i Buxhetit, Financës dhe Burimeve Njerëzore
**Miratoi**: **Ina Stefa/** Përgjegjës Sektori i Buxhetit, Financës dhe Burimeve Njerëzore
**Përparim Mezini/** Përgjegjës i Sektorit Juridik
**Aprovoi**: **Afërdita Rokaj/** Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE**
**DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr._90_prot. Tiranë, më 01.02.2023

**Lënda**: Përcillet relacioni mbi informimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës '*Për Miratimin e Buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2023*'

**TIRA N Ë**

Për kompetencën Tuaj, lutemi gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese, relacionin mbi informimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës ''*Për Miratimin e Buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industrial, për vitin 2023*''

Duke Ju falënderuar,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ROVENA BEQIRAJ**

Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri(AL)
Web Site: www.dppi.gov.al E-mail: info@dppi.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Nr. 90/1 prot. Tiranë, më 01 / 02 / 2023

dppi
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

# RELACION

**Tiranë, Shkurt 2023**

Znj. Meka, të përcillet materiali informues Këshillit Mbikëqyrës

Informacion '*Për Miratimin e Buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industrial, për vitin 2023*'

Me vendim nr.33. datë 27.01.2023 të Këshillit të Ministrave, u vendos miratimi i buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2023.

Duke parë tabelen nr.1 të cilit i bashkangjitet vendimit nr.33 datë 27.01.2023 dhe tabelës së Vendimit me nr. 11 datë 02.11.2022 të paraqitur pranë Këshillit Mbikqyrës, shprehemi se nuk ka asnjë ndryshim në planin e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe në tabelën me detajimin sipas zërave përkatës për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industrial, për vitin 2023.

PLANI TË ARDHURA – SHPENZIME, PËR VITIN 2023,
PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

| Të ardhurat | 000/lekë | Shpenzimet | 000/lekë |
|---|---|---|---|
| **Të ardhura nga aktiviteti kryesor** | **135,000** | **Shpenzime personeli** | **55,821** |
| **Të trashëguara investime dhe projekte në vazhdim** | **92,769** | **Shpenzime operative dhe korrente** | **25,716** |
| Marrëveshja e Madridit | 66,000 | Transferta korrente të jashtme | 90,000 |
| Marrëveshja e Hagës | 1,000 | Shpenzime kapitale | 123,332 |
| Të ardhura nga marrëveshja e shtrirjes me ZEP | 100 | **Totali i shpenzimeve** | **294,869** |
| | | Teprica derdhje në buxhetin e shtetit | 0 |
| **Totali i të ardhurave** | **294,869** | **Totali i shpenzimeve dhe teprica në Buxhetin e Shtetit** | **294,869** |

Në mbledhjen e datës 06.02.2023 pikë e rendit të ditës është njohja e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës me vendimin nr.33.datë 27.01.2023 të Këshillit të Ministrave 'Për Miratimin e Buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industrial, për vitin 2023' i cili nuk ka pësuar asnje ndryshim nga programi financiar i paraqitur dhe i miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës.

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Afërdita Rrokaj

Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit,
Financës dhe Burimeve Njërzore

Ina Stefa

Detajimi.

## BUXHETI i DPPI-se PER VITIN 2023 Janar-Dhjetor

(Ne mije leke)

| Nr | ZERAT | PLAN Viti 2022 |
|---|---|---|
| A. KL.7 | **TE ARDHURAT** | |
| 1 | Aktivitet kryesor, aplikime kombetare | **135.000** |
| 2 | Të trashëg. invest, proj. ne vazh. | **92.769** |
| 3 | Marreveshje e Madridit | **66.000** |
| 4 | Marreveshja e Hages | **1.000** |
| 5 | Te ardhura nga ZEP | **100** |
| | **TOTALI I TE ARDHURAVE** | **294.869,00** |
| B. Kl. 4 | **TE TJERA DETYRIME** | |
| 4381000 | Te tjera detyrime, Te vitit ne vazhdim (2023) | - |
| 4382000 | Te tjera detyrime, Te vitit te meparshem(2022) | **1.740** |
| 4383000 | Te tjera detyrime, Te viteve te meparshme(2020+2021) | **2.178** |
| | **TOTALI I DETYRIMEVE** | **3.918** |
| C.600+601 | **SHPENZIME PERSONELI** | |
| 1001 | Paga e administrates | 39.000 |
| 2100 | Paga me kontrate per kohe te kufizuar | 2.521 |
| 0000 | Sigurime Shoqerore , Shendetesore | 14.300 |
| | **SHUMA** | **55.821** |
| | | |
| C. | **SHPENZIME KORRENTE** | |
| **602.'0** | **Materiale zyre dhe te pergjithshme** | |
| 0100 | Kancelari | 200 |
| 0200 | Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje, ndriçim | 200 |
| 0300 | Materiale per funks e pajiste zyres. **Toner/Dram** | 1.200 |
| 0400 | Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale (Kuti Arkivi+dosje per ruajtje te perhershme) | - |
| 0500 | Blerje dokumentaconi( kuti arkive) | |
| 0900 | Furniz dhe mater te tjera zy dhe te pergj. Mat promov | - |
| **602,1** | **Materiale dhe sherbime speciale** | |
| 1007 | Libra dhe publikime profesionale -Raport/Stratgji | 250 |
| 1010 | Shpenzim per prodhim dokumentacioni specifik/ revista 3-mujore | 0 |

| | | |
|---|---|---|
| 1099 | Te tj mat dhe shpz spec(konsulenca), spote publ.perkthime,konferenca. Spotet publicitare sherbejne per promovimine e fushes se PI, ku promovimi eshte nje nga dy shtyllat kryesore te ligjit 9947 dhe eshte detyrim promovimi i saj. Perkthimi I akteve nenligjore si detyrim i anetaresimit te DPPI-se ne organizma nderkombetare, WIPO, EPO, EUIPO. Ne faqen zyrtare duhet te jene te perkthyera ne gjuhen angleze. | 3.000 |
| **602,2** | **Sherbime nga te tretet** | |
| 2001 | Elektricitet | 2.000 |
| 2002 | Uje | 500 |
| 2003 | Sherbime telefonike | |
| | Telefoni fikse | 150 |
| | Telefoni celular | 150 |
| 2004 | Posta dhe sherbimi korrier | 400 |
| 2005 | Sherbim per ngrohje | |
| 2007 | Sherbimet bankare | 150 |
| 2008 | Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes | 4.000 |
| 2009 | Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit | |
| 2010 | Sherbime te printimit dhe publikimit | |
| 2011 | Kosto e trajnimit dhe seminareve | - |
| 2099 | Sherbime te tjera. | - |
| 6870 | Fondi i emergjencave 2% | - |
| **602,3** | **Shpenzime transporti** | |
| 3100 | Karburant dhe vaj | 600 |
| 3200 | Pjese kembimi , goma , bateri | 120 |
| 3300 | Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit | 100 |
| 3400 | Shpenzime te tjera transporti | 98 |
| **602,4** | **Shpenzime udhetimi** | |
| 4000 | Udhetim i brendshem | 1.000 |
| 4200 | Udhetim jashte shtetit | 4.000 |
| **602,5** | **Shpenzime per mirembajtje te zakonshme** | |
| 5200 | Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore | - |
| 5500 | Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit | - |
| 5800 | Shpenzime per mirembajtjen e pajisjeve te zyrave | 900 |
| **602,6** | **Shpenzime per qiramarrje** | |
| 6100 | Shpenzime per qiramarrje ambjentesh | 1.600 |
| 6400 | Shpenzime per qiramarrje mjetesh transporti | |

| | | |
|---|---|---|
| 6900 | Shpenzime te tjera qiraje | |
| **602,7** | **Shpenzime per detyrime dhe kompesime legale** | |
| 7500 | Shpenzim per ekzekutim te dety. kontr. pa paguara | |
| 7900 | Shpenzime per kompesime te tjera ta papaguara | |
| **602,8** | Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua | |
| 8100 | Shpenzime per kuota qe rrjedhin nga detyrimet | |
| **602,9** | **Shpenzime te tjera operative** | |
| 9001 | Shpenzime per pritje dhe percjellje | 250 |
| 9002 | Shpenzime per aktivitete sociale per personelin | |
| 9003 | Shpenzime gjyqesore | - |
| 9005 | Shpenzime per honorare( Bordi+K.Mbikqyres) | 800 |
| 9007 | Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca | 100 |
| 9008 | Shpenzime per tatime &taksa te paguara nga institu. | 30 |
| | | |
| **E.604** | **TRANSFERIME KORRENTE TE BRENDESHME** | |
| | **SHUMA** | **25.716** |
| **F.605** | **TRANSFERIME KORRENTE JASHTE** | |
| 1099 | Transferta Organizma Nderkombetare; WIPO | 0 |
| 1099 | zbatim te nenit 39 te Konventes Europiane te Patentave | 90.000 |
| | **SHUMA** | **90.000** |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **115.716,00** |
| | | |
| **G.231.4** | **SHPENZIME KAPITALE TE TRUPEZUARA** | |
| **G.231.8** | **SHPENZIME KAPITALE TE TRUPEZUARA** | |
| 214 | Orendi zyre | - |
| 214 | Pajisje kompjuterike | - |
| | **TOTAL SHPENZIME kapitale ve te trupezuara** | - |
| **I.230** | **SHPENZIME KAPITALE TE PATRUPEZUARA** | |
| | | |
| | Kosto mirmbajteje per programet e ndryshme te DPPI-se | 132 |

| | | |
|---|---|---|
| | Nderlidhja  e web nga projekt twining me faqen zyrtare te DPPI-se dhe kosto e mirmbajtjes | 1.200 |
| | Projekt mbi rritjen e ndërgjegjësimit tek brezat e rinj dhe stafet pedakogjikë të ciklit të ulët dhe të mesëm | 6.000 |
| | Projekt mbi studimin, identifikim dhe nxitjen e rregjistrimit te Treguesve Gjeografik | 3.000 |
| 0004 | AKSHI | 107.000 |
| | **Projekti per 30 Vjetorin** | 6.000 |
| | | |
| | **TOTAL SHPENZIME KAPITALE TE PATRUPEZUARA** | **123.332** |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE** | **123.332** |
| | **TOTAL SHPENZIME KORRENTE DHE INVESTIMESH+DETYRIMET** | **294.869** |

P/Sektori F,B,BNJ
INA STEFA

DR. DREJTORIE
AFERDITA RUKAJ